



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM

Nr. 22, datë 28.07.2025

**PËR LEJIMIN E ZONJËS GENTA TAFI (BUNGO) NË VENDIN VAKANT, PËR
GJYQTAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA GJYKATA E
LARTË MË DATË 11.12.2024**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga:

Sokol Sadushi	Kryetar
Marjana Semini	Zëvendëskryetare
Ilir Toska	Anëtar
Thoma Jano	Anëtar zëvendësues
Elvana Çiçolli	Anëtar zëvendësues
Enkela Vlora	Anëtare relatore
Irma Balli	Anëtare
Etien Kapo	Anëtar
Nafije Hasko	Anëtare

Asistuar nga sekretare Ermelinda Kadiu, me praninë e Avokates së Popullit, zonjës Erinda Ballanca, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED), në mungesë të përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve: zonjës Evis Fico përfaqësuese e autorizuar e Kryetarit të Kuvendit; në mungesë të përfaqësuesve të autorizuar të Presidentit të Republikës, z. Ilir Rusmajli dhe znj. Fiorida Ballauri, dijeni kanë pasur rregullisht sipas ligjit; në mbledhjen e datës 28.07.2025, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDATIT: Genta Tafi (Bungo)

Kandidim për gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese në vendin vakant të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë më datë 30.09.2024.

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al; Numra telefonikë : +355 4 2257302

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares së KED-it, zonjës Enkela Vlora, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, zonja Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Informacion i përgjithshëm mbi kandidaturën dhe caktimin e relatorit

1. Në zbatim të Nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të Nenit 7/ç të Ligjit Nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, më datë 11.12.2024, Gjykata e Lartë ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, pas deklarimit të mbarimit të mandatit të gjyqtarës Holta Zaçaj.
2. Në përfundim të afatit të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Gjykata e Lartë i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, listën e kandidatëve që kanë shprehur interes për këtë vend vakant në Gjykatën Kushtetuese, në të cilën përfshihej dhe kandidatja **Genta Tafa (Bungo)**, së bashku me dokumentacionin e paraqitur prej tyre, për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore, të përcaktuara në nenin 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000.
3. Në datë 15.01.2025, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), realizoi procedurën e shortit për përzgjedhjen e anëtarit relator dhe të këshilltarit ligjor për këtë vakancë, sipas Nenit 228 të Ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pikës 4 të vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar (në vijim vendimi nr. 4/2019 i KED) dhe vendimit të KED-së nr. 2 datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”, i ndryshuar. Me anë të kësaj procedure, relatore për këtë vakancë u përzgjodh anëtarja Enkela Vlora, ndërsa këshilltare ligjore Bjorka Duka.

II. Informacion mbi ecurinë e procedurës së verifikimit të kandidaturës

4. Në datë 17.01.2025, kandidatja **Genta Tafa (Bungo)** u njoftua me shkrim, në rrugë elektronike për t’u paraqitur brenda tre ditëve në zyrën e posaçme të KED-së për tërheqjen e formularëve standard dhe të udhëzimeve të nevojshme për vijimin e procedurës së verifikimit të kandidimit të tij. Ky njoftim u krye në zbatim të pikës 22 të vendimit nr. 4/2019 të KED-

së. Gjithashtu në zbatim të detyrimeve ligjore të parashikuara në Ligjin Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar; si dhe Vendimin nr.4, datë 11.3.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, kandidates **Genta Tafa (Bungo)** i është njoftuar dhe emri i relatores dhe këshilltares së caktuar.

5. Në datën 17.01.2025, kandidatja **Genta Tafa (Bungo)** në rrugë elektronike, konfirmoi marrjen e njoftimit. Kandidatja nuk ka bërë me dije shkaqe papajtueshmërie, konflikt interesi ose pengesa ligjore sipas Nenit 222 dhe 223 të Ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në lidhje me relatoren dhe këshilltaren.
6. Në datë 20.01.2025, kandidatja Genta Tafa (Bungo), u paraqit pranë KED dhe tërhoqi për plotësim formularët standard të deklarimit dhe autorizimet e duhura për procedurën e aplikimit për plotësimin e vendit vakant, objekt i kësaj procedure verifikimi, midis të cilave edhe ato për deklarimin e pasurisë dhe interesave financiarë. Në datë 22.01.2025, dhe 24.01.2025 kandidatja është paraqitur pranë KED për dorëzimin e autorizimeve dhe deklarimeve përkatëse.

III. Verifikimi i kushteve dhe kriterëve kushtetuese dhe ligjore të kandidimit

A. Procesi i deklarimit dhe kontrolli i pasurisë së kandidatës dhe familjarëve të saj sipas ligjit.

7. Për llogaritjen dhe ndjekjen e zbatimit të afatit të parashikuar në pikën 2 të Nenit 235 të Ligjit Nr. 115/2016, të Nenit 7/a pika 1 germa “dh” të Ligjit Nr. 8577/2000, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi me nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr.64 prot, datë 29.01.2025, Këshilli i ka dërguar, ILDKPKI-së, listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procesit të kontrollit të pasurive, interesave financiarë dhe konfliktin e interesave, sipas të Ligjit Nr. 9049/2003, të ndryshuar, dhe Ligjit Nr. 9367/2005.
8. Bashkëlidhur kësaj shkrese të drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është përcjellë dhe “Deklarata” e nënshkruar nga kandidatja Genta Tafa (Bungo), në të cilën tregohet/konfirmohet se është pajisur me formularët përkatës të deklarimeve dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së saj, dhe që mban datën 21.01.2025 të nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatet për procedurën e verifikimit të kandidaturës.
9. Në zbatim të Nenit të Nenit 235 pika 2 të Ligjit Nr. 115/2016, të Nenit 7/a pika 1 germa “dh” të Ligjit Nr. 8577/2000, dhe pikës 61 të vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit

të Lartë të Drejtësisë”, si dhe përcaktimeve të neneve 3/1, 4 pika 2 e vijues të ligjit 9049/2003, kandidatja Genta Tafa (Bungo) ka plotësuar në mënyrë elektronike dhe ka dorëzuar të printuar e nënshkruar, brenda 15 ditëve, pranë ILDKPKI-së, Deklaratën e “pasurisë dhe interesave privatë të kandidatës për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë”, të konfirmuar nga kjo e fundit me shkresën nr.766/1, datë 17.02.2025.

10. ILDKPKI-ja, në zbatim të Ligjit Nr. 9049/2003 dhe Ligjit Nr. 9367/2005, si dhe të Nenit 235 të Ligjit Nr. 115/2016 dhe vendimit nr. 4 të datës 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, pasi ka kryer verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe interesave private të kandidatës, ka përcjellë Akt- Kontrollin e plotë të *Deklaratës së Pasurisë dhe Interesave Privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë*, për Genta Tafa (Bungo) për Gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, me nr. 4/23 prot, datë 02.05.2025, ku është konkluduar se për kandidaten Genta Tafa (Bungo):

- a) Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- ç) Nuk ka kryer deklarim të rremë;
- d) Nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave

B. Deklarimi dhe kontrolli i kushteve të tjera ligjore

11. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, të Nenit 237 dhe 240 të Ligjit Nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91/93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli ka shqyrtuar dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidatja Genta Tafa (Bungo) në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant, si dhe informacionet e siguruara nga KED, zyrtarisht në kuadër të këtij procesi.

i. Kontrolli mbi shtetësinë dhe zotësinë për të vepruar

12. Neni 7/a pika 1 shkronja “a” e Ligjit Nr. 8577/2000 parashikon si kusht kandidimi shtetësinë shqiptare dhe zotësinë e plotë për të vepruar. Kandidatja Genta Tafa (Bungo), me atësi Leka, amësi Luljeta, lindur më datë 26.08.1971 në Tiranë dhe banuese në Tiranë, me nr. personal H15826095Ë, sipas certifikatës së lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, rezulton me shtetësi shqiptare. Përgjatë procedurës së verifikimit nuk ka rezultuar asnjë e dhënë që kandidatit t’i jetë hequr apo t’i jetë kufizuar zotësia për të vepruar.

ii. Kontrolli për ushtrim funksione politike dhe/ose pozicione drejtuese ne parti politike

13. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e Nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, pra që kandidatja të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi me vendimin nr. 2, datë 23.02.2022, ka miratuar ndryshimet në vendimin nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, duke bërë pjesë të tij “Formularin e vetëdeklarimit nga kandidati për anëtar i Gjykatës Kushtetuese për pozicione drejtuese të mbajtura në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit”, i cili u botua në fletoren zyrtare nr. 33, datë 01.03.2022. Këto ndryshime u kushtëzuan nga fakti se në praktikën e KED-së në vitet të mëparshme, partitë politike, nuk dërgonin informacionin e nevojshëm, duke ndikuar dhe vështirësuar marrjen e informacionit lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin e kandidatëve në ndonjë pozicion drejtues në parti politike.
14. Në zbatim të këtij detyrimi kandidatja Genta Tafa (Bungo) ka dorëzuar të plotësuar formularin e vetëdeklarimit datë 21.01.2025, duke deklaruar se nuk ka pasur ndonjë pozicion drejtues në parti politike.
- Deri në momentin e hartimit të këtij relacioni, nuk ka dalë apo nuk është identifikuar ndonjë e dhënë që të vërë në dyshim deklarin e bërë nga kandidati, në lidhje me mbajtjen e posteve drejtuese në partitë politike.
- Po ashtu nuk konstatohet që gjatë dhjetë viteve të fundit kandidati të ketë ushtruar funksione politike.

iii. Kontrolli mbi arsimin e lartë juridik

15. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e Nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “b” e pikës 1 të Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, pra që kandidatja të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidatja **Genta Tafa (Bungo)**, ka përfunduar studimet e larta në Universitetin e Tiranës në Fakultetin e Drejtësisë në periudhën 1989-1993, duke u diplomuar në datë 28.09.1993 me titullin “Jurist”.
- Në zbatim të neneve 75 dhe 124 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë.
16. Në aktet e administruara në dosjen e kandidates **Genta Tafa (Bungo)**, ka rezultuar i provuar fakti se, kjo e fundit ka kryer studime pasuniversitare në programin “*Master në Shkencat*

Publike” pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, në periudhën 2001-2003 dhe ka mbrojtur mikrotezën me temë “*Tatimet e dyfishta*”.

17. Gjithashtu, në aktet e administruara në dosjen e kandidatës **Genta Tafa (Bungo)**, ka rezultuar i provuar fakti se, kjo e fundit ka kryer studime doktorature pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, dhe ka fituar gradën shkencore “*Doktor*” në të drejtën publike (*disertacion me temë “Mbi tatimet e dyfishta”*), me nr. 147 diplome, datë 18.06.2008.
18. Gjithashtu, në aktet e administruara në dosjen e kandidatës **Genta Tafa (Bungo)**, ka rezultuar i provuar fakti se, kjo e fundit ka fituar titullin “*Profesor i Asociuar*”, me nr. Dëshmie 29, lëshuar nga Universiteti i Tiranës, më 03.06.2014.

iv. Kontrolli mbi përvojën profesionale të kandidatës në punë

19. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e Nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, pra që kandidatja të ketë *të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtare, prokurore, avokate, profesore ose lektore e së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike*, nga librezja e punës së kandidatës rezulton dokumentuar përvoja e punës si vijon:

1. Nga data 16.11.1993 deri në datë 16.01.1996 – Specialiste pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme – periudha e punësimit 2 (dy) vite e 2 (dy) muaj.
2. Nga data 01.02.1996 deri në datë 15.09.2003 – Asistent Pedagoge pranë Fakultetit të Drejtësisë, Universiteti i Tiranës – periudha e punësimit 7 (shtatë) vite, 7 (shtatë) muaj, 14 (katërmëdhjetë) ditë.
3. Nga data 16.09.2003 deri në datë 30.06.2004 – Përgjegjës Sektori Juridik pranë Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit – periudha e punësimit 9 (nëntë) muaj e 14 (katërmëdhjetë) ditë. Në faqen e largimit ka një shënim “Kalon në detyrë tjetër”.
4. Nga data 01.07.2004 deri në datë 23.12.2005 – Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Integritetit, në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit (sot Ministrisë së Brendshme) – periudha e punësimit 1 (një) vit, 5 (pesë) muaj e 22 (njëzet e dy) ditë. Në faqen e largimit ka një shënim “Ristrukturim, del ne listë pritje”.
5. Nga data 23.12.2005 deri në datë 23.12.2006 – Drejtor i Drejtorisë Juridike pranë Ministrisë së Brendshme – periudha e pritjes në listë pritje 1 (një) vit. Në faqen e largimit ka një shënim “Përfundon lista e pritjes”.
6. Nga data 01.01.2009 deri në datë 29.02.2012 – Pedagoge në Universitetin “Justiniani” shpk– periudha e punësimit 3 (tre) vjet, 1 (një) muaj e 28 (njëzet e tetë) ditë.
7. Nga data 01.07.2012 deri në datë 16.07.2013 – Juriste pranë “Debit Collection” shpk- periudha e punësimit 1 (një) vit, e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë.

8. Nga data 13.07.2013 deri në datë 28.06.2017 – Përmbarues gjyqësor pranë “Speed Solution” shpk- periudha e punësimit 3 (tre) vite, 11 (njëmbëdhjetë) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë.
 9. Nga periudha 17.06.2017- 20.06.2020- Anëtare/ Kryetare e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit – periudha e punësimit 3 (tre) vite, e 3 (tre) ditë.
 10. Nga periudha 21.06.2020- 31.12.2024- Anëtare e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit – periudha e punësimit 4 (katër) vite, 5 (pesë) muaj, e 3 (tre) ditë.
20. Gjithashtu, nga dokumentacioni i shqyrtuar (jetëshkrimi) kandidatja **Genta Tafa (Bungo)** ka deklaruar se ka përmblusur edhe veprimtaritë profesionale të mëposhtme:
1. Nëntor 2016 - Mars 2017- Lektore e ftuar, në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti Luarasi
 2. Nëntor 2014 - Qershor 2017 - Sekretar i Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë
 3. Shtator 2013 - Shkurt 2014 - Lektore e ftuar, Fakulteti i Drejtësisë, Albanian University
 4. Tetor 2012 - Mars 2013 - Lektore e ftuar, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti “Aleksander Xhuvani”
 5. Mars 2013 – (pa datë përfundimi) Udhëheqës disertacioni në Shkollën Doktorale, UET
 6. Janar 2009 - Shkurt 2012- Përgjegjës i Departamentit të së Drejtës Publike, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti Justiniani
 7. Mars 2007 - Qershor 2010- Pedagoge e Jashtme, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti “Kristal”
 8. 2004 -2008 - Pedagoge e Jashtme, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti Luarasi
 9. Janar - Korrik 2003- Këshilltare e Jashtme pranë Ministrit të Integritetit
21. Në lidhje me verifikimin e kriterit të vjetërsisë, masave disiplinore dhe performancës në detyrë, në përputhje me kërkesat e Nenit 7/a, pika 2 e Ligjit Nr. 8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese" KED ka çmuar të nevojshme të verifikojë për atë sa rezultojnë e mundur të gjitha marrëdhëniet e punës të dokumentuara në librezën e punës së kandidatës, rrjedhimisht i është drejtuar institucioneve pranë të cilave rezultojnë se kandidatja ka ushtruar marrëdhëniet e punësimit sipas pasqyrimit në librezën e punës.
- Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, të Nenit 237 dhe 240 të Ligjit Nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91 - 93 të vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, pavarësisht të dhënave të pasqyruara nga librezja e punës, jetëshkrimi apo edhe dokumentacionit shkresor të paraqitur nga kandidatja, Këshilli për

shkak të kryerjes së një hetimi të thelluar në drejtim të këtij kriteri, ka kryer një korrespondencë shkresore me të gjithë institucionet ku kandidatja **Genta Tafa (Bungo)** ka ushtruar veprimtari profesionale, duke kërkuar informacion për këto çështje: (i) marrjen e konfirmimit të periudhës kohore që ka ushtruar veprimtari profesionale pranë tyre; (ii) kërkimin e akteve të emërimit dhe të largimit nga detyra; (iii) konfirmimin dhe marrjen e të dhënave në lidhje me performancën në punë (masa disiplinore, vlerësim në punë apo shkakun e largimit nga detyra); (iv) përshkrimin e detyrave funksionale dhe veprimtarinë ligjore që ka mbuluar në kryerjen e këtyre detyrave.

22. Lidhur me marrëdhënien e punësimit të kandidates si **Asistent pedagoge pranë Fakultetit të Drejtësisë së Universitetit të Tiranës**, ky i fundit me shkresën nr. 185/1 prot., datë 21.02.2025 ka bërë me dije KED informacionin si më poshtë:

“ Genta Leka Tafa (Bungo)

Vijueshmëria e marrëdhënies së punës: Kandidatja ka qenë pedagoge efektive në Departamentin e së Drejtës Publike, pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në periudhën 01.02.1996 - 15.09.2003. Ndërprerja e marrëdhënieve të saj të punës është bërë me kërkesë të saj, për arsye personale. Kandidatja ka qenë asistent-pedagoge efektive.

Detyra funksionale: Përveç se asistent-pedagoge pranë Departamentit të së Drejtës Publike, më 24.03.2003, me vendim të Dekanit të Fakultetit të Drejtësisë, Prof.Dr. Kudret Çela, ajo është emëruar përgjegjëse e seksionit të lëndëve teorike dhe historisë së Drejtësisë, vendim i cili ka hyrë në fuqi më 01.04.2003. Ajo gjithashtu ka qenë pedagoge me kohë të pjesshme pranë Fakultetit të Drejtësisë në vitin akademik 2003-2004.

Vlerësime performancë: Në dosjen e personelit të larguar, që disponohet pranë Degës së Burimeve Njerëzore, nuk ka vlerësime të performancës në detyrë.

Masat disiplinore: Në dosjen e personelit të larguar, që disponohet pranë Degës së Burimeve Njerëzore, nuk ka informacion për masat disiplinore.”

23. Lidhur me marrëdhënien e punësimit të kandidates si **Përmbaruese Gjyqësore**, në përgjigje të kërkesës së KED për informacion, Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë me shkresën nr.1267 Prot., datë 17.03.2025 ka përcjellë informacionin si më poshtë:

“1. Periudha në të cilën përmbaruesja Genta Tafa Bungo ka ushtruar profesionin e përmbarueses gjyqësore private, si anëtare e Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë dhe e regjistruar në "Regjistrin e përmbaruesve gjyqësorë privatë" me datë fillimi aktiviteti 31.7.2013 - dhe me datë pezullimi aktiviteti 25.7.2017.

2. Përmbarduesja Genta Tafa Bungo nuk ka të regjistruar vlerësime të performancës së saj në detyrë apo akte të ngjashme të kësaj natyre;

3. Referuar regjistrin të masave disiplinore, përmbarduesja Genta Tafa Bungo nuk ka të regjistruar masë disiplinore gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.”

24. Po në lidhje me këtë periudhë punësimi, KED i ka kërkuar informacion edhe Ministrisë së Drejtësisë, ku kjo e fundit nëpërmjet shkresës Nr. 1159 Prot., datë 17.03.2025 ka përcjellë informacionin si më poshtë:

“Znj. Genta Leka Tafa (Bungo), është licencuar nga Ministria e Drejtësisë si përmbardues gjyqësor privat në muajin maj 2013 dhe ka pezulluar certifikatën e ushtrimit të veprimtarisë përmbardimore në datën 25.07.2017, me kërkesën e saj.

Për znj. Genta Leka Tafa (Bungo), bashkëlidhur, do të gjeni shkresën nr.3697, datë 18.07.2013 dhe Urdhrin nr.4140/1, datë 25.07.2017.”

25. Lidhur me marrëdhënien e punësimit të kandidates si **Përgjegjëse Sektori të Asistencës Ligjore dhe Draftimit në Drejtorinë Juridike dhe të Integritetit në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit** (sot Ministria e Brendshme), në përgjigje të kërkesës së KED për informacion, Ministria e Brendshme me shkresën nr.1953/3 Prot., datë 10.04.2025 ka përcjellë informacionin si më poshtë:

“Nga verifikimi i të dhënave në Regjistrin e Personelit dhe në dosjen personale të administruar, rezulton se znj. Genta Leka Tafa (Bungo) ka ushtruar këto funksione:

Nga data 16.09.2003 deri më datë 30.06.2004, ka qenë Përgjegjëse i Sektorit të Asistencës Ligjore dhe Draftimit, në Drejtorinë Juridike dhe Integritetit, në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit;

Nga data 01.07.2004 deri më datë 23.12.2005, ka ushtruar detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Juridike dhe Integritetit, në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit;

Më datë 23.12.2005, me urdhrin nr. 2753 prot., të Ministrit të Brendshëm, është liruar nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë Juridike dhe Integritetit dhe është kaluar në listën e pritjes;

Nga data 23.12.2005 deri më datë 23.12.2006, ka qenë në listë pritje (bashkëlidhur aktet përkatëse).

Lidhur me vlerësimin e performancës në detyrë, në dosjen personale të saj janë administruar dy formularë vlerësimi, (bashkëlidhur formularët). Po ashtu, gjatë periudhës së vijueshme të marrëdhënies së punës, rezulton se znj. Genta Leka Tafa (Bungo) nuk ka marrë asnjë masë disiplinore.”

26. Në lidhje me periudhën e vlerësimit 16.09.2003- 01.11.2003 sipas Formularit të Vlerësimit të Punës, nënshkruar më 07.11.2003 nga Sekretari i Përgjithshëm, punonjësja ka marrë vlerësimin 1 (Sh. Mirë). Pa shënim.

27. Po në këtë formular të vlerësimit të punës, nën seksionin B, parashikohen dhe detyrat funksionale të kandidatës në cilësinë e Përgjegjëses së Sektori të Asistencës Ligjore dhe Draftimit në Drejtorinë Juridike dhe të Integritimit si më poshtë:

“Seksioni B

Qëllimi i Përgjithshëm i Punës: Organizimi i punës brenda sektorit. Ndjekja e kuadrit ligjor të procesit të decentralizimit dhe të projektakteve në ngarkim. Përmbyllja e detyrave që dalin gjatë zbatimit të tyre. Hartimi i informacioneve të hollësishme ligjore (informative) për eprorin dhe titullarin. Bashkëpunimi me drejtoritë e M.P.V.D.-se dhe me drejtoritë homologe në institucione të tjera. Raportimi tek eproret për mbarëvajtjen e punës brenda sektorit.”

28. Në lidhje me pozicionin e mbajtur: Drejtor të Drejtorisë Juridike dhe Integritimit, në Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, në Urdhërin Nr. 78, datë 01.07.2004 të Emërimit, pika 3, specifikohet së pagesa të bëhet me Klasën II-B, lidhja nr.1 e Vendimit Nr. 711, datë 27.12.2001, të Këshillit të Ministrave “Për strukturat dhe nivelet e pagave të nëpunësit civil.

29. Në lidhje me periudhën e vlerësimit 01.11.2003- 28.06.2004 dhe 28.06.2004- 31.10.2004 sipas Formularit të Vlerësimit të Punës, nënshkruar më 31.10.2004 nga Sekretari i Përgjithshëm, punonjësja ka marrë vlerësimin 2 (Mirë), më shënimin: “*Është korrekte dhe realizon në kohë dhe cilësi detyrat e ngarkuara. Duhet të tregojë më shumë impenjim në shfrytëzimin e burimeve të komunikimit me drejtoritë e tjera.*”

30. Po në këtë formular të vlerësimit të punës, nën seksionin B, parashikohen dhe detyrat funksionale të kandidatës në cilësinë e Drejtores së Drejtorisë Juridike dhe Integritimit si më poshtë:

“Seksioni B

Qëllimi i Përgjithshëm i Punës: Organizimi i punës brenda sektorit dhe me pas brenda drejtorisë. Ndjekja e kuadrit ligjor të procesit të decentralizimit dhe të projektakteve në ngarkim. Përmbyllja e detyrave që dalin gjatë zbatimit të tyre. Hartimi i informacioneve të hollësishme ligjore (informative) për eprorin dhe titullarin. Bashkëpunimi me drejtoritë e M.P.V.D.-se dhe me drejtoritë homologe në institucione të tjera. Koordinimi i punës për organizimin e aktiviteteve jashtë vendit. Raportimi tek eproret për mbarëvajtjen e punës brenda sektorëve.”

31. Në lidhje me pozicionin e mbajtur, **Pedagoge pranë Universitetit “Justiniani”shpk**, sipas librezës së punës ka qenë punësim me kohë të plotë dhe nuk figuron mbivendosje me

pozicione të tjera. Duke qenë se këtij të fundit i është hequr licenca me anë të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 539, datë 06.08.2014, KED iu drejtua me kërkesë për informacion Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, e cila me anë të shkresës Nr. 1328/1, datë 03.03.2025, përcolli informacionin si më poshtë:

“Në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit nga shkolla e lartë universitare jopublike "Justiniani I", janë depozituar vetëm regjistra të matrikullimit dhe notave, programe studimi dhe dosjet e studentëve që ishin ende në proces studimi.

Sa më sipër, referuar kërkesës suaj lidhur me marrëdhënien e punësimit, specifikimit të detyrave funksionale, vlerësimit të performancës në detyrë, si dhe nëse gjatë marrëdhënies së punës është marrë masë disiplinore për znj. Tafa (Bungo), MAS nuk ka në administrim një dokumentacion të tillë.”

32. Në këto kushte dhe bazuar mbi parashikimet e VKM Nr. 539, pika III/ ç dhe VIII, KED iu drejtua me kërkesë për informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, e cila me anë të shkresës Nr. 3542/1 Prot., datë 07.04.2025 përcolli informacionin si më poshtë:

“Në përgjigje të kërkesës suaj me nr. 189 prot., datë 01.04.2025, lidhur mbi të dhëna punësimi si pedagoge pranë Institucionit të Arsimit të Lartë "Justiniani I", në emër të Genta Leka Tafa (Bungo), ju bëme me dije se pranë Arkivit Qendror Shtetëror për këtë institucion, disponojmë vetëm regjistrat e amzave dhe notave dhe jo dokumentacion administrativ.”

33. Në lidhje me pozicionin e mbajtur, **Anëtare dhe Kryetare e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**, KED i është drejtuar organit të emërtesës Kuvendit të Shqipërisë me kërkesë për informacion, ku ky i fundit ka përcjellë me anë të shkresës Nr.1408/1 Prot., datë 23.04.2025 informacionin si më poshtë:

Znj. Genta Leka Tafa (Bungo) e datëlindjes 26.08.1971, identifikuar me nr. personal H15826095Ë (ish-komisionere në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit 2017-2024).

“...Znj. Genta Leka Tafa (Bungo) është zgjedhur në funksionin e anëtares në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me vendimin nr.82 të Kuvendit të Shqipërisë, datë 17.6.2017, "Për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, sipas Ligjit Nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Bazuar në nenin 179/b, pika 8, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet: "Mandati i anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Komisionerit Publik përfundon në datën 31.12.2024...", mandati znj. Genta Leka Tafa (Bungo) ka përfunduar më 31.12.2024.”

Në lidhje me masat disiplinore: Duke qenë se të gjithë kandidatët e mësipërm kanë ushtruar funksione si anëtarë të institucioneve të rivlerësimit, bazuar në nenin 17, pika 4, të Ligjit Nr.

84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", masat disiplinore ndaj anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit jepen nga një komision disiplinor me 3 gjyqtarë të Kolegjit të Apelimit. Në këto kushte, për çështjet që kërkojnë për këtë pikë duhet t'i drejtoheni Kolegjit të Apelimit."

Bashkëlidhur shkresës së mësipërme gjendet: - Vendimi nr. 82/2017 i Kuvendit të Shqipërisë, "Për miratimin e listës në bllok të kandidatëve të zgjedhur në institucionet e rivlerësimit, sipas Ligjit Nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

34. Ndërsa, **Kolegji i Posaçëm i Apelimit** me shkresën nr. 592/1 prot., datë 06.05.2025, ka bërë me dije KED se, "... në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për fillimin e hetimit disiplinor, në kuadër të parashikimit të Nenit 17, pika 2 e Ligjit Nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe, si rrjedhojë, nuk rezulton të ketë masë disiplinore gjatë vijueshmërisë së marrëdhënies së punës për ish-Komisionerët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Genta Tafa (Bungo). Gjithashtu, në funksion të veprimtarisë suaj në vijim, ju informojmë se nga Kolegji nuk është filluar/marrë masë disiplinore për asnjë nga ish-anëtarët e dy institucioneve të rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Komisionerët Publikë, gjatë vijueshmërisë së marrëdhënies së tyre të punës,"

35. Në lidhje me eksperiencat e referuara nga kandidatja në jetëshkrim si **Lektore e ftuar, apo pedagoge me kohë të pjesshme**, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 25.06.2025 kërkoi informacion nga Universitetet Private ku janë ushtruar këto eksperiencat:

36. Në datën 26.06.2025, nëpërmjet e-mailit **Albanian University** referoi ne pergjigjen e tij se:

Genta Leka Tafa (Bungo) ka qenë e angazhuar pranë "Albanian University" si Personel akademik me kohë të pjesshme.

1. Zj. Tafa ka qenë e angazhuar në semestrin e dytë të vitit akademik 2008-2009, përkatësisht, Mars 2009- Qershor 2009 dhe në semestrin e parë të vitit akademik 2013-2014 përkatësisht, Tetor 2013-Shkurt 2014. Marrëdhënia e punës ka përfunduar natyrshëm dhe nuk ka patur arsye për largim.

Zj.Tafa ka qenë Personel akademik me kohë të pjesshme. Detyrat që përmban ky pozicion përfshijnë mësimdhënien, zhvillimi i rregullt i procesit mësimor në përputhje me ngarkesën e përcaktuar nga departamenti.

Ngarkesa mësimore në semestrin e dytë të vitit akademik 2008-2009 ka qenë 27 orë mësimore dhe në semestrin e parë të vitit akademik 2013-2014 ka qenë 50 orë mësimore.

Nuk ka patur vlerësim të performancës në detyrë. Gjatë angazhimit në institucionin tonë nuk ka marrë asnjë masë disiplinore.

37. Në datën 30.06.2025, nëpërmjet shkresës së përcjellë me email me nr. 618 Prot., **Universiteti "Barleti"** referoi në përgjigjen e tij:

Znj. Genta Leka Tafa (Bungo), e datëlindjes 26.08.1971, ka qenë pedagoge me kohë të pjesshme në Universitetin "Barleti" për vetëm një lëndë semestrale në periudhat si më poshtë:

Viti akademik 2008-2009, semestri 1, mësimdhënie në lëndën "Sociologjia e Ligjit", në Fakultetin e Shkencave Humane, me 28 orë leksion të realizuara.

Viti akademik 2009-2010, semestri 1, mësimdhënie në lëndën "Sociologjia e Ligjit", në Fakultetin e Shkencave Humane, me 15 orë leksion të realizuara.

Gjatë këtyre periudhave nuk rezulton që institucioni të ketë kryer vlerësime performance për pedagogët e jashtëm, një prej të cilëve ishte edhe Znj. Genta Leka Tafa (Bungo).

Nuk rezulton asnjë masë disiplinore për personin në fjalë.

38. Në datën 30.06.2025, nëpërmjet shkresës së përcjellë me email me nr. 380/1 Prot., Universiteti European i Tiranës referoi në përgjigjen e tij:

Znj. Tafa ka qenë e angazhuar në UET në cilësinë e udhëheqëses shkencore në ciklin e tretë të studimeve në programin e doktoratës « Shkenca Juridike » në Fakultetin Juridik.

Në funksion të këtij angazhimi, ndërmjet UET dhe znj. Tafa është lidhur një marrëveshje konsulence me afat të pacaktuar, e vlefshme deri në mbrojtjen e disertacionit nga doktorantët që ajo ka pasur në udhëheqje.

Sipas kësaj marrëveshjeje, znj. Tafa ka patur për detyrë të drejtojë punën kërkimore dhe hartimin e disertacionit të doktorantëve, në kuadër të përmbushjes së kërkesave për marrjen e gradës shkencore "Doktor". Konkretisht, detyrimet e znj. Tafa si udhëheqëse shkencore përfshinin:

1. Bashkëpunimin me doktorantët për përgatitjen e reçensave dhe raporteve të progresit, në funksion të përmirësimit dhe finalizimit të disertacionit;

2. Pjesëmarrjen në Ditët Doktorale, në përputhje me kalendarin e shpallur nga Shkolla Doktorale dhe ditën e Mbrojtjes Finale të Disertacionit nga ana e doktorantit.

Gjatë angazhimit të saj në këtë rol, znj. Tafa ka udhëhequr tre doktorantë, të cilët kanë zhvilluar mbrojtjen finale të disertacionit në vitin 2015, 2016 dhe 2021. Gjithashtu, në vitin 2015, znj. Tafa ka qenë e pranishme në një komision të mbrojtjes finale të disertacionit, në cilësinë e oponentit të jashtëm.

Znj. Genta Tafa ka ushtruar funksionin e udhëheqëses shkencore në mënyrë korrekte dhe profesionale, pa pasur ankesa nga doktorantët saj dhe nuk ka qenë asnjëherë objekt i ndonjë mase disiplinore.

39. Në datën 02.07.2025, nëpërmjet shkresës së përcjellë me email me nr. 177/1 Prot., Universiteti "Luarasi" referoi në përgjigjen e tij se:

"Znj. Genta Tafa (Bungo), me Nr. Personal H15826095Ë, ka qenë e punësuar si pedagoge me kohë të pjesshme për periudhën 2004-2006 dhe vitin Akademik 2016 - 2017, pranë Fakultetit të Drejtësisë, UNIVERSITETIT "LUARASI" Tiranë."

40. Nëpërmjet shkresës nr.1357 prot., datë 05.06.2025 lëshuar nga Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, të sjellë nga vetë kandidatja rezulton e vërtetuar se kandidatja ka punuar si punonjëse akademike me kohë të pjesshme në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, në Fakultetin Ekonomik (Fakulteti i biznesit dhe drejtësisë) ku në periudhën 2012-2013- ka zhvilluar 129 orë mësimi.

41. Bazuar në të dhënat që janë përfutur nga të gjitha institucionet e treta, pranë të cilave Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka marrë informacion, si dhe nga të dhënat që pasqyrohen nga librezat e punës dhe dokumentet e tjera shkresore të administruara nga vetë kandidatja Genta Tafa (Bungo), është arritur në konkluzionin se në lidhje me plotësimin e kushtit ligjor të përcaktuar në nenin 7/a, pika 2, shkronja “a”, si dhe pika 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 8577/2000, Nenit 237 dhe 240 të Ligjit Nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91 - 93 të vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, rezulton se kandidatja Genta Tafa (Bungo) provon me dokumentacion të rregullt ligjor ushtrimin e profesionit të juristit *me kohë të plotë pune* pranë organeve kushtetuese, administratës shtetërore publike, në sektorin privat dhe profesionet e rregulluara, një vjetërsi prej 27 vitesh, 7 muajsh dhe 9 ditësh. Rezulton gjithashtu se kandidatja Genta Tafa (Bungo) është angazhuar *me kohë të pjesshme* në fushën e mësimdhënies.

Në nenin 7/a të Ligjit Nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, është parashikuar se:

“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;

c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;

ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;

d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;

- b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;
- c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.

3. Plotësimi i kriterëve të mësipërme vlerësohet në bazë të:

- a) vjetërsisë në profesion;
- b) përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese a Gjykatës së Lartë;
- c) kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;
- ç) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;
- d) ecuresë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlershme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimit përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës;
- dh) informacioneve të marra nga institucione të tjera publike....”.

42. Ndërsa në pikën 97/1 të vendimit nr. 4, datë 30.11.2019, i ndryshuar “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, është parashikuar se: “Ndalimi i kandidimit vendoset në rastet kur nga dokumentacioni i paraqitur nga kandidati, si edhe nga shkresat e dërguara nga subjektet publike dhe private, rezulton se kandidati nuk plotëson kushtin e parashikuar, nga neni 7/a, pika 2, shkronja “a” të Ligjit Nr. 8577/2000 për kandidimet në Gjykatën Kushtetuese, në lidhje me përvojën 15 vjet “jurist i nivelit të lartë në administratën publike”. Kandidati “jurist i nivelit të lartë në administratën publike” për qëllim të këtij vendimi, do të konsiderohet juristi i cili ushtron apo ka ushtruar një detyrë të nivelit të lartë drejtues në organet e sistemit të drejtësisë apo administratën publike përmes së cilës ka arritur të akumulojë ndër vite gjatë karrierës së tij/saj një eksperiencë të pasur profesionale lidhur me çështje të të drejtës kushtetuese, të të drejtave të njeriut, të të drejtës publike, që e lejon të japë një kontribut me kualifikim të lartë profesional dhe vlera të çmueshme juridike në juridiksionin kushtetues”.
43. Bazuar në përmbajtjen e dispozitave të mësipërme, si dhe faktit që kandidatja Genta Tafa (Bungo), provon me dokumentacion të rregullt ligjor ushtrimin e profesionit të juristit me kohë të plotë pune pranë organeve kushtetuese, administratës shtetërore publike, në sektorin privat dhe profesionet e rregulluara private një vjetërsi 27 vitesh, 7 muajsh dhe 9 ditësh, por që në mënyrë të pavarur mes këtyre shërbimeve vlerësohet plotësimi i eksperiencës në punë prej 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike që përbën kriter ligjor të përcaktuar në nenin 7/1, pika 2, shkronja “a” të Ligjit Nr. nr. 8577/2000, në datën 31.05.2025, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i është drejtuar në rrugë elektronike kandidates Genta Tafa (Bungo), duke i kërkuar të përcjellë

parashtrimet e saj në lidhje me veprimtarinë profesionale të ushtruar prej saj, parë në dritën e parashtrimeve të lartpërmendura.

44. Në datat 05.06.2025 dhe 06.06.2025, Znj.Tafa (Bungo) paraqiti një përmbledhje të plotë të karrierës së saj akademike dhe profesionale, duke theksuar se, ndonëse formalisht është emëruar si asistente pedagoge, ka ushtruar funksione të plota të një pedagogeje/lektore në Fakultetin e Drejtësisë, UT, përfshirë mbajtjen e leksioneve, përgatitjen e materialeve mësimore dhe drejtimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm. Ajo ka përfunduar studimet master në vitin 2003 dhe ka mbrojtur gradën “Doktor i Shkencave” në vitin 2008, ndërsa në vitin 2014 ka marrë titullin “Profesor i Asociuar”. Ka ushtruar funksione të rëndësishme në administratë dhe në institucione akademike, si dhe ka shërbyer në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, duke përmbushur kriteret e përcaktuara nga legjislacioni për përvojë profesionale e akademike. Ajo kërkon që vlerësimi i saj të bazohet në përmbajtjen reale të funksioneve të ushtruara dhe jo thjesht në tituj formalë.

- **Propozim i Relatorit në lidhje me vijueshmërinë e procesit dhe propozim për marrjen e vendimit nga ana e KED.**

45. Relatorja e çështjes, pasi ka marrë në analizë të gjithë dokumentacionin ligjor shkresor të administruar në dosjen e kandidatit, ka parashtruar që mendon se në këtë fazë të shqyrtimit, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi duhet që:

1. *Të marrë në shqyrtim çështjen me një vendim përfundimtar;*
2. *Të vlerësojë dhe konkludojë se nuk ka vend që të vijohet me hetim të thelluar në drejtim të kriterit pasuror, pasi hetimi dhe analizimi i kësaj çështje nga ana e ILDKPI, është i plotë, i mirëarsyetuar dhe i bazuar në dokumentacionin shkresor të depozituar nga vetë kandidati dhe organet e tjera;*
3. *Të vlerësojë dhe konkludojë se nuk ka vend që të vijohet me hetim të thelluar në drejtim të kriterëve të tjera pasi kandidatja nuk plotëson një nga kushtet ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, posaçërisht përvojën profesionale 15 vjeçare.*
4. *Në rastin konkret, mendoj se duhet të merret vendim për ndalimin e kandidimit të kandidates Genta Tafa (Bungo) për shkak të mos plotësimit të kushteve të parashikuara në nenin 7/a, pika 2 të Ligjit Nr. 8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese" dhe Vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë" ndryshuar me vendimin nr. 4, datë 23.11.2023, të KED;*

46. Në përgjigje të Relacionit të relatores të datës 03.07.2025, dërguar kandidates nëpërmjet emailit me datë 04.07.2025 dhe të shkresave të dërguara nga universitetet, kandidatja paraqiti

parashtrimet e datës 07.07.2025, të përmbledhura si më poshtë lidhur me përshtatshmërinë e saj sipas Nenit 7/a, pika 2 të Ligjit Nr. 8577/2000 për vendin e gjyqtarit në Gjykatën Kushtetuese:

Znj. Tafa pretendon se përvoja e saj profesionale plotëson kriterin e përvojës 15-vjeçare si lektore e së drejtës dhe juriste e nivelit të lartë. Ajo nisi karrierën akademike në vitin 1996 si asistente pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, në Departamentin e së Drejtës Publike. Megjithëse me titull formal asistente, ajo pohon se në praktikë ka ushtruar funksionet e plota të një pedagoge, duke qenë titullare e lëndës “E drejta financiare,” duke zhvilluar leksione dhe seminare, përgatitur materiale mësimore dhe koordinuar pedagogë të jashtëm – detyra të rezervuara zakonisht për personelin akademik me tituj të lartë. Këto pohime mbështeten në dokumente të departamentit dhe rregullore universitare, përfshirë edhe emërimin e saj si përgjegjëse e seksionit teorik në vitin 2003.

Ajo gjithashtu ka përmendur angazhimin në universitete të ndryshme jopublike gjatë viteve 2006–2013, përfshirë Universitetin Kristal, Luarasi, Albanian University dhe Universitetin Barleti. Ndërmjet viteve 2009–2012, ka qenë pedagoge me kohë të plotë pranë Universitetit “Justiniani I”. Ajo ka përfutur titullin “Doktor i Shkencave” në vitin 2008 dhe “Profesor i Asociuar” në vitin 2014. Nga viti 2017 deri në vitin 2023, ka ushtruar funksionin e Komisioneres dhe Kryetares së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (KPK), një institucion kushtetues, duke argumentuar se ky funksion quasi-gjyqësor përmbush kërkesat ligjore.

Znj. Tafa mbështet pretendimet e saj me dokumente të shumta, përfshirë vërtetime universitare, ekstrakte bankare që provojnë pagesat për mësimdhënie dhe emërimet zyrtare. Ajo gjithashtu i referohet përzgjedhjes së saj të mëparshme në KPK si provë e përmbushjes së kriterëve të ngjashme ligjore. Ajo përfundon duke kërkuar që vlerësimi të mos bazohet vetëm në titujt formalë, por edhe në përmbajtjen reale të detyrave të kryera, kontributin akademik dhe besimin institucional të treguar gjatë viteve. Ajo thekson se provat e paraqitura dëshmojnë një karrierë profesionale që përputhet plotësisht me kërkesat ligjore për kandidaturën në Gjykatën Kushtetuese.

47. Në mbledhjen e datës 15.07.2025, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi mori në shqyrtim sa më lart.

➤ **Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi**

48. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi pasi mori në bisedim çështjet e adresuara nga relatorja e çështjes, që i janë bërë me dije edhe kandidates, e cila ka dhënë opinionin e saj në lidhje me to, arriti në konkluzionin që pasi është marrë në studim raporti përfundimtar i kontrollit të dërguar nga organi ndihmës ILDKPI, e gjithë veprimtaria hetimore administrative është bërë në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi, janë kryer të gjitha korrespondencat e nevojshme pranë institucioneve të treta për të marrë informacion dhe të dhëna në lidhje me pasuritë e luajtshme të të paluajtshme të kandidates Genta Tafa (Bungo). Gjithashtu, ka rezultuar se nga ana e ILDKPKI është bërë një pasqyrim dhe arsyetim i qartë në lidhje me identifikimin dhe provueshmërinë e ligjshmërisë së pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi të

kandidates Genta Tafa (Bungo) dhe personave të lidhura me të, duke mos pasur asnjë indicie që të vijohet me një hetim më të thelluar nga ai që ka kryer ILDKPI.

49. Bazuar sa më sipër, Këshilli vlerëson se në këtë rast kontrolli i kryer nga ILDKPI është i plotë, i saktë dhe në kushtet e mungesës së të dhënave që do të vinin në dyshim konkluzionet dhe të dhënat e pasqyruara në akt-kontrollin përfundimtar të pasurisë, arrihet në konkluzionin se kandidatja Genta Tafa (Bungo) e kalon me sukses *kriterin e verifikimit të pasurisë*, duke provuar se disponon pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të ligjshme. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr.115/2016, kandidati nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të pasurisë.
50. Në vijim të analizimit të *eksperiencës/përvojës profesionale* që kandidatja Genta Tafa (Bungo) ka ushtruar në administratën publike, në ushtrimin e veprimtarisë pranë institucioneve të pavarura të krijuara me ligj si dhe ushtrimit të aktivitetit të mësimdhënies, *Këshilli arrin në konkluzionin* se kandidatja e plotëson kushtin ligjor të përcaktuar në nenin 7/a, pika 2, shkronja “a” të Ligjit Nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe përcaktimet e pikës 97/1 të vendimit nr. 4, datë 30.11.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar.
51. **Në këto kushte, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vendosi se vjetërsia e kandidates në ushtrimin e detyrave të dokumentuara në librezën e saj të punës dhe jetëshkrim është si vijon:**

-Specialiste pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme, nga data 16.11.1993 deri në datë 16.01.1996 – periudha e punësimit 2 (dy) vite e 2 (dy) muaj- *Pozicion i nivelit të ulët, detyrat funksionale nuk përkojnë me kriteret ligjore;*

-Asistent pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës; nga data 01.02.1996 deri në datë 15.09. 2003 – periudha e punësimit 7 (shtatë) vite, 7 (shtatë) muaj, 14 (katërmëdhjetë) ditë- *Pozicion i nivelit të ulët, detyrat funksionale nuk përkojnë me kriteret ligjore;*

-Përgjegjëse sektori në Ministrinë e Brendshme (ish Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit), nga data 16.09.2003 deri në datë 30.06.2004 – periudha e punësimit 9 (nëntë) muaj e 14 (katërmëdhjetë) ditë - *Pozicion i nivelit të mesëm, detyrat funksionale nuk përkojnë me kriteret ligjore;*

-Drejtor i Drejtorisë Juridike pranë Ministrisë së Brendshme (ish Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit), nga data 01.07.2004 deri në datë 23.12.2005 – periudha e punësimit 1 (një) vit, 5 (pesë) muaj e 22 (njëzet e dy ditë) ditë - *Përvojë e vlefshme për kandidim*

- Pedagoge në Universitetin “Justiniani” shpk, nga data 01.01.2009 deri në datë 29.02.2012 – periudha e punësimit 3 (tre) vjet, 2 (dy) muaj - *Përvojë e vlefshme për kandidim.*
- Juriste pranë “Debit Collection” shpk, nga data 01.07.2012 deri në datë 16.07.2013 – periudha e punësimit 1 (një) vit, e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, *detyrat funksionale nuk përkojnë me kriteret ligjore.*
- Përmbarues gjyqësor pranë “Speed Solution” shpk, nga data 13.07.2013 deri në datë 28.06.2017 - periudha e punësimit 3 (tre) vite, 11 (njëmbëdhjetë) muaj e 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, *detyrat funksionale nuk përkojnë me kriteret ligjore.*
- Komisionere/ Kryetare pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nga data 17.06.2017 - 31.12.2024, kohëzgjatja në detyrë 7 (shtatë) vjet, 6 (gjashtë) muaj e 14 (katërmëdhjetë) ditë.Funksion kushtetues - *Përvojë e vlefshme për kandidim.*

52. **Në lidhje me periudhat jo të vlefshme për kandidim**-Këshilli vlerëson se pozicionet e punës që kandidatja Genta Tafa (Bungo) ka mbajtur në administratën publike si specialiste¹, përgjegjëse sektori² nuk janë pozicione pune nga ato që ka parashikuar ligji për ta barasvlerësuar këtë eksperiencë profesionale me atë të “juristit të nivelit të lartë në administratën publike”.Ky konkluzion i Këshillit gjen referencë tek përcaktimet e Ligjit Nr. 8549, datë 11.11.1999 dhe nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” (i ndryshuar) si dhe VKM –te përkatëse mbi përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura,ku janë përcaktuar se cili është pozicioni në hierarkinë e administratës publike që i përshtatet termit “*jurist i nivelit të lartë të administratës publike*”.
53. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në rastin objekt shqyrtimi, vlerëson se eksperiencia prej 7 vitesh e 7 muajsh e 14 ditësh e kandidates Genta Tafa (Bungo) **si asistent -pedagoge ne Fakultetin e Drejtësisë së Universitetit të Tiranës, nuk mund të përlllogaritet si eksperiencë pune nga ajo që kërkon neni 7/a, pika 2, shkronja “a” e Ligjit Nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi, kandidatja Genta Tafa, gjatë kohës që ka ushtruar këtë aktivitet në mësimdhënie nuk ka mbajtur asnjë gradë shkencore nga ato që ka parashikuar ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.**
54. Bazuar në të dhënat zyrtare të konfirmuara nga Fakulteti i Drejtësisë, konstatohet se kandidatja ka ushtruar funksionin “*asistent pedagog*” me kohë të plotë (efektiv) në Departamentin e së Drejtës Publike, pranë Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, në periudhën 01.02.1996-15.09.2003 (7 vjet e 7 muaj e 14 ditë).

¹ Ministria e Puneve te Jashtme 1993-1996

² Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit

55. Sipas përgjigjes së kthyer nga Fakulteti, dhe dokumentacionit të sjellë nga kandidatja vetë në përgjigje të kërkesës së KED për të identifikuar përvojat e vlefshme për kandidim, rezultoi se kandidatja është emëruar ‘asistente’ në vitin 1996 dhe ndërkohë nuk ka patur një tjetër emërim, apo ndryshim titulli. Në përfundim të punësimit me kohë të plotë pranë Fakultetit, ajo ka qenë asistent pedagoge (me kohë të pjesshme) në të njëjtin fakultet në vitet akademike 2003-2004. Vetë kandidatja deklaroi që: *‘Dëshiroj të nënvizoj një fakt thelbësor dhe me rëndësi të veçantë: pavarësisht se emërimi im zyrtar ka qenë si asistente pedagoge...’*.
56. Referuar Ligjit Nr. 7810, datë 4.1.1994 (në fuqi deri në 1999), asistent-pedagogu konsiderohej si pjesë e punonjësit mësimor-shkencor (profesorë, asistentë profesorë, pedagogë, asistentë, etj.), të brendshëm dhe të jashtëm. Nga përmbajtja e këtij ligji nuk rezultoi të jenë përcaktuar kritere për kategorizimin e punonjësve mësimor – shkencor në profesor, asistentë profesorë, pedagogë, asistentë pedagogë referuar rolit dhe veprimtarisë që kryen. Detyrat dhe të drejtat e personelit të shkollave të larta parashikoheshin në statutet dhe rregulloret e brendshme të shkollës. Gjithashtu, ky ligj parashikonte edhe kategorinë e personelit ndihmës -shkencor (preparatorë, laborantë etj.). (shih nenin 25 të ligjit) .
57. Referuar VKM nr. 351, datë 30.6.1993 *“Për kualifikimin shkencor pasuniversitar dhe klasifikimin e punonjësve pedagogjikë e kërkimorë”*, në nenin 4 me titull “4. Klasifikimi i punonjësve pedagogjikë e kërkimorë” parashikonte se:

“4.1 Klasifikimi pedagogjiko-shkencor i personelit pedagogjik dhe atij kërkimor bëhet për vendet që ka çdo njësi (katedra, sektori etj.), në përputhje me nivelin e kualifikimit, veprimtarinë e zhvilluar, leksionet e dhëna, punimet e kryera, artikujt, tekstet e monografitë e botuara, pjesëmarrjen në seminare, kolokiume e konferenca shkencore brenda e jashtë vendit, drejtimin e veprimtarive pedagogjike në shkollat e larta në lëndë të caktuara ose drejtimin e kërkimit në fusha të ndryshme të shkencës.

*4.2 Punonjësit pedagogjikë të universiteteve e të shkollave të tjera të larta, në varësi nga vendi e roli që kanë në veprimtarinë e mësimdhënies dhe nga kontributi i tyre personal shkencor, klasifikohen: **4.2.1 PROFESOR** emërtohet punonjësi pedagogjik i shkollave të larta me përvojë të gjatë mësimdhënieje, që është autor tekstesh origjinale universitare, hartues programesh për lëndë a cikle speciale, autor artikujsh shkencorë e monografish, që ka drejtuar katedra ose ka qenë titullar lëndësh a grupe-lëndësh, ka udhëhequr diploma a disertacione dhe zotëron disa gjuhë të huaja, për dy nga të cilat ka dëshminë përkatëse.*

***4.2.2 ASISTENT PROFESOR** emërtohet punonjësi pedagogjik i shkollave të larta me përvojë të gjatë mësimdhënieje, që është autor tekstesh universitare, autor artikujsh e monografish, që ka qenë titullar lëndësh, ka udhëhequr diploma e disertacione dhe që zotëron dy gjuhë të huaja, për të cilat ka dëshminë përkatëse.*

4.2.3 PEDAGOG është punonjësi pedagogjik me gradën "Doktor i shkencave", që jep leksione sipas programeve dhe teksteve të autorëve të tjerë, është autor artikujsh shkencorë, ka udhëhequr diploma universitare dhe zotëron një gjuhë të huaj, për të cilën ka certifikatën përkatëse.

4.2.4 ASISTENT është kuadri i lartë i atashuar për punë ndihmëse pranë katedrës ose mësimdhënësve të tjerë. Kur përgatitet për pedagog, ndjek SHPU dhe doktoratën."

58. Ndërsa sipas VKM nr. 786, datë 17.12.1998 "Për kualifikimin shkencor, pasuniversitar dhe për klasifikimin e punonjësve, pedagogjikë e kërkimorë", në nenin 4. me titull "Klasifikimi i punonjësve pedagogjikë e kërkimorë", parashikohej ndër të tjera se:

"4.1. Klasifikimi pedagogjiko-shkencor i personelit mësimdhënës dhe atij kërkimor bëhet në përputhje me nivelin e kualifikimit, veprimtarinë e zhvilluar, leksionet e dhëna, punimet e kryera, artikujt, tekstet e monografitë e botuara, pjesëmarrjen në seminare, kolokiume e konferenca shkencore, brenda dhe jashtë vendit, drejtimin e veprimtarive pedagogjike në shkollat e larta, në lëndë të caktuara ose drejtimin e kërkimit në fusha të ndryshme të shkencës.

4.2. Punonjësit pedagogjike të universiteteve e të shkollave të tjera të larta, në varësi nga vendi e roli që kanë me veprimtarinë e mësimdhënies dhe nga kontributi i tyre kërkimor-shkencor, klasifikohen si vijon:

4.2.1. "**Profesor**" (**Prof**) emërtohet punonjësi pedagogjik i shkollave të larta, që është "Profesor i asociuar" të paktën prej katër vjetësh, që ka qenë titullar lëndësh a grup lëndësh, që ka udhëhequr diploma të shkollave pasuniversitare ose të shkollës së lartë, si dhe ka udhëhequr të paktën 1 disertacion, që është autor ose bashkautor kryesor i një a më shumë teksteve universitare, të një cilësie të lartë, është hartues programesh për lëndë a cikle lëndësh të veçanta, autor artikujsh shkencorë e monografish ose drejtues projektsh shkencore, që ka drejtuar seksione (katedra), departamente ose ekipe kërkimore në fushën e vet, që ka qenë pjesëmarrës në konferenca shkencore, brenda ose jashtë vendit, dhe ka botuar artikuj a kumtesa jashtë vendit.

Përrjashtimi nga kriteret e mësipërme bëhet vetëm me vendim të Komisionit të Kualifikimit Shkencor.

4.2.2. "**Profesor i asociuar**" (**Prof.as.**) emërtohet punonjësi pedagogjik i shkollave të larta, që është "Doktor i shkencave", me përvojë mësimdhënieje jo më pak se 10 vjet, që është autor ose bashkautor tekstesh universitare, autor artikujsh e kumtesash, të publikuara brenda dhe jashtë vendit, si dhe autor monografish ose realizues arritjesh të rëndësishme shkencore, që ka udhëhequr diploma të shkollës pasuniversitare ose të shkollës së lartë, si dhe që zotëron, sipas dëshmisë përkatëse, gjuhën angleze, ose, në

vend të saj, dy gjuhë të huaja, njëra prej të cilave frëngjishtja dhe tjetra njëra nga gjuhët e huaja, të treguara në listën e pikës 2.4.

4.2.3. “Lektor” (Pedagog) është punonjësi pedagogjik i shkollave të larta, me gradë “Doktor i shkencave”, që jep leksione, që është autor artikujsh shkencorë, që ka udhëhequr diploma universitare.

4.2.4. “Asistent” është specialisti i lartë, që zhvillon seminare, ushtrime dhe punë laboratorike pranë njësive mësimdhënëse, i cili përgatitet për t’u bërë “lektor” (pedagog) dhe ndjek shkollën pasuniversitare dhe doktoratën.

59. Kjo VKM nuk është shfuqizuar nga Ligji i ri vijues Nr.8461/1999 dhe as më pas. Me Ligjin Nr.8461, datë 25.2.1999 (në fuqi deri në 2007), Neni 26, personeli i shkollave të larta rigrupohet si personel akademik i brendshëm dhe i jashtëm dhe personel ndihmës mësimor-shkencor.
60. Me Ligjin Nr. 9741, datë 21.5.2007 (në fuqi deri në 2015), personeli i institucionit të arsimit të lartë rigrupohet në: personel akademik, personel ndihmës mësimor -shkencor dhe personel administrativ. Sipas Nenit 47 të këtij ligji, personeli akademik sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen kategorizohet në: 1. *Profesorë, anëtar të personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë së kërkimit shkencor (gradë shkencore “Doktor” dhe titujt akademikë: “Profesor i asociuar”, “Profesor”, “Profesor emeritus” dhe “Akademik),* 2. *Docentë, anëtarë të personelit akademik që zhvillojnë kryesisht veprimtari mësimore (titull akademik “Docent” ose gradë shkencore “Doktor”) dhe* 3. *Lektorë, anëtarë të personelit akademikë që zhvillojnë veprimtari mësimore - kërkimore (diplomë Master i Nivelit të Dytë).* (shih nenet 46, 47 të ligjit)
61. Ndërkohë, sipas Ligjit Nr. 80/2015 (në fuqi), personeli akademik kategorizohet në: a) profesorë, b) lektorë (grada shkencore “Doktor”), c) asistent-lektorë (diplomë Master i shkencave). (shih nenin 59 të ligjit). Personeli akademik, i punësuar në institucionet e arsimit të lartë, i kategorisë “Docent”, në kuadër të përcaktimeve të Ligjit Nr. 9741, datë 21.5.2007, konsiderohet “Lektor”, ndërsa personeli akademik i kategorisë “Lektor”, konsiderohet “Asistent lektor”.
62. Në interpretim të dispozitave të mësipërme “asistent pedagogu” mund të konsiderohet i afërt me “asistent-lektorin”, por vetëm nëse përmbush kriteret e ligjit në fuqi. Sipas akteve në fuqi të cituara më lart, në vitet 1993–2003, asistenti është kuadri i lartë i atashuar për punë ndihmëse pranë katedrës ose mësimdhënësve të tjerë, i cili përgatitej për t’u bërë “lektor” (pedagog) dhe ndiqte shkollën pasuniversitare dhe doktoratën. Ndërsa pedagogu mbante gradën “Doktor” dhe jepte leksione, ishte autor tekstesh e artikujsh, udhëheqës diplomash universitare. Rregullimi ligjor/nënligjor i sipërcituar, lidhur me pedagog/lektor kërkon plotësimin e njëkohshëm-klasifikimin dhe kualifikimin, që do të thotë klasifikimi i tillë kërkon domosdoshmërisht dhe kualifikimin: doktor i shkencave.

63. Me Ligjin Nr. 80/2015 personeli akademik kategorizohet në profesor, lektor dhe asistent-lektor. Lektor i është anëtar i personelit akademik që zhvillon veprimtari mësimore dhe kërkimore shkencore dhe mban gradën “Doktor”. Asistent-lektor i është personeli akademik që zhvillon veprimtari mësimore-kërkimore, ka minimumi diplomën “Master i shkencave” dhe plotëson kriteret e institucionit. Sipas ligjit aktual, titulli asistent pedagog i kohës nuk paraqitet më si kategori akademike, por vetëm nëse përmbush kriteret e asistent-lektorit (diplomë master, plotësim kriteresh shtesë), mund të rikategorizohet në këtë pozicion por jo në atë të “lektorit”. Në raste të tjera, nuk konsiderohet personeli akademik, por ndihmës mësimor-shkencor, sikurse përcaktojnë statutet dhe ligjet në fuqi.
64. Në rastin e kandidates, bazuar në provat e paraqitura nga ajo vetë, dhe nga Fakulteti i Drejtësisë rezultojnë:
- të ketë filluar punë në Fakultet e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës në vitin 1996 në pozicionin asistente;
 - në shkresa të ndryshme vijuese paraqitet si pedagoge, por nuk kemi një emërim të tillë;
 - ka zhvilluar leksione dhe seminare;
 - është emëruar shefe/ përgjegjëse e seksionit të lëndëve teorike, në Departamentin e të Drejtës Publike në vitin 2003
 - në periudhën e konsideruar për efekt të këtij hetimi, ajo ka ndjekur dhe studimet pasuniversitare të Nivelit Master në periudhën 2001-2003 në përkufizimet e evidentuara më lart Pedagogu apo Lektor i parashikohet me gradën Doktor dhe në ndryshim nga asistenti i cili nuk parashikohet që të ndjekë studimet pasuniversitare apo doktorale.
 - ka kryer studime doktorature pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, dhe ka fituar gradën shkencore “Doktor” në të drejtën publike (disertacion me temë “Mbi tatimet e dyfishta”), me nr. 147 diplome, datë 18.06.2008.
65. Kandidatja në parashtrimet e saj ka theksuar se detyrat e kryera në periudhën 1996-2003 pavarësisht se të kryera nën titullin e *asistent-pedagoges*, kanë qenë për pozicionin e pedagoges, duke qenë se ajo efektivisht ka ushtruar detyrën e plotë të një lektoreje për sa kohë një asistent-pedagog nuk ka të drejtë të zhvillojë leksione në mënyrë të pavarur, të jetë titullar i lëndës, apo të ushtrojë funksione drejtuese akademike, përfshirë dhe të jetë Përgjegjës seksioni lëndësh, apo përpilimi dhe miratimi i planeve mësimore, si dhe koordinimi të bashkëpunëtorëve të jashtëm.
66. Përsa më lart për periudhën objekt hetimi 1996-2003 nga njëra anë jemi përpara klasifikimit të kandidates “*asistent pedagog*” i pasqyruar në aktet rregulluese të kohës, i tillë që nga momenti i emërimit dhe deri në përfundim të marrëdhënies së punës në vitin 2003; nga ana tjetër jemi para mungesës së gradës shkencore ‘Doktor’ e parashikuar nga aktet rregulluese të kohës, gjë e cila do të thotë se nuk përmbushet asnjëri nga kriteret e ligjit: klasifikimi dhe kualifikimi. Ushtrimi efektivisht i detyrës së pedagoges për shkak të

rrethanave të kohës apo dhe vetë aftësive personale të subjektit nuk mund të dalë jashtë kornizës ligjore dhe tej kushteve të kohës: Klasifikimit ‘pedagog’ dhe kualifikimit ‘Doktor i shkencave’. Grada Doktor i shkencave nuk është një kriter formal dhe i tillë të anashkalohet përsa kohë pasqyron nivel kualifikimi dhe në fakt nuk është anashkaluar nga organet e emërtesës së kohës të cilat e kanë klasifikuar kandidaten, pavarësisht punës së saj, në ‘asistent pedagoge’ deri në përfundim të marrëdhënies në vitin 2003- periudhë pa gradë shkencore. Ushtrimi efektivisht i detyrës së pedagoges në mungesë të klasifikimit dhe kualifikimit, nuk ekuivalenton përvojën e kandidates me konceptin e Nenit 7/a të ligjit për ‘lektor’ dhe në këtë kontekst nuk arrin kufirin e vlefshmërisë së kësaj periudhe për kandidim.

67. Gjithashtu në mbështetje të pretendimeve të saj, kandidatja ka përcjellë pranë KED dhe vendimin nr. 76, datë 18.05.2023, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, që ka lënë fuqi vendimin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë që ka rrëzuar pretendimet e një ish-subjekti të rivlerësimit se përzgjedhja e saj në funksionin e komisionerit binte ndesh me kriteret ligjore.
68. Në përmbajtje të këtij vendimi të Gjykatës së Posaçme të Apelit gjejmë të parashtruar/lidhur me çështjen në shqyrtim nga KED dhe kallëzimin e bërë nga pala kallëzuese sipas të cilës *“zgjedhja nga Kuvendi i RSH e shtetases Bungo/Tafa është bërë në kundërshtim me ligjin material nenin 6 i ligjit 84/2016, pasi nuk ka plotësuar vjetërsinë në punë prej 15 vitesh sipas Nenit...”*.
69. Në lidhje me pretendimin për plotësimin e kriterit ligjor të vjetërsisë në punë të shtetases Genta Tafa Bungo, konkretisht se ajo nuk ka 15 vite në momentin e përzgjedhjes si komisioniere e se qenia asistent pedagoge nuk mund të barazohet me pedagogen, nga ana e prokurorisë është argumentuar jo vetëm që një fakt i tillë nuk egziston por dhe nëse do të ekzistonte do të vlente analiza e bërë në lidhje me nenin 6 të ligjit 84/2016. Pra këto kriterë mund të vlerësohen vetëm nga organet e emërtesës sikurse janë komisionet parlamentare *ad hoc*. Prokuroria e Posaçme çmon se ushtrimi i detyrës si asistente pedagoge sipas ligjit të kohës nuk do të thotë se nuk ushtron funksionin e juristit sipas Nenit 6/1/b të Ligjit 84/2016 për tu konsideruar përvojë e njohur në fushën e të drejtës. Shtetasja Genta Tafa (Bungo) është me gradë shkencore, dokumentacion që e ka paraqitur që në momentin e shprehjes së interesit. Edhe gjykata e posaçme e Apelit e gjen të drejtë analizën dhe arsyet e gjykatës së posaçme të faktit duke vlerësuar se është i pabazuar pretendimi i palës kallëzuese për mospërmbushje kriteri/periudhe vjetërsie në fushën e të drejtës nga komisionierja...Ndryshe nga sa pala kallëzuese pretendon del qartë që shtetasja ... Tafa ka më tepër se 15 vite përvojë pune të kërkuar sipas kriterit. Gjithashtu, gjykata vlerëson se të theksojë se shtetasja ...Tafa ka fituar gradën Doktor i Shkencave në Drejtësi më datë 18.06.2008, fakt që del nga diploma doktoratës lëshuar nga Universitetit i Tiranës.
70. Këshilli vlerëson se referuar sa më lart kemi të bëjmë me një vendim gjyqësor penal të formës së prerë, përsa kohë që çështja është shqyrtuar nga gjykata, por e tillë në kontekstin e

veprës penale, pra nëse shtetasja e kallëzuar kishte konsumuar elementë të tillë të parashikuar nga neni 186 i KPenal.

71. Ajo çka është e rëndësishme në trajtimin e këtij vendimi, në raport me çështjen për shqyrtim në KED, është fakti që në thelb është konkluduar se kriteret ligjore sipas Ligjit Nr. 84/2016, ku përfshihej dhe vjetërsia, shqyrtohen dhe vlerësohen vetëm nga organet kompetente të emërtesës; janë këto organe të cilat në çmuarje të tyre—gjithë dokumentacionit të paraqitur dhe mbledhur dhe sipas procedurës së parashikuar në ligj, konkludojnë me vendimin përkatës duke mos pasur vend në këtë këndvështrim për vepër penale të kryer nga subjekti kandidat që në çmuarje ka vlerësuar që i plotëson kushtet dhe ka bërë kërkesë pranë organit kompetent të kohës. Prokuroria dhe më pas gjykata penale kanë bërë një analizë në funksion të elementëve të veprës penale lidhur me deklarin e kandidatës në kërkimin e saj në çmuarje të vjetërsisë në punë, sipas vlerësimit të organeve të emërtesës nga njëra anë dhe vepra penale e kallëzuar nga ana tjetër.
72. Nisur nga sa më lart është e qartë se vlerësimi i bërë nga organi i akuzës dhe më pas gjykata, e cila ka trajtuar ligjshmërinë e vendimit të mos fillimit të procedimit penal nga ana e prokurorit të çështjes, nuk cënon hetimin e zhvilluar nga KED, ku ky i fundit analizon çështjen në kuptim të Nenit 7/a të ligjit 8577/2000, të ndryshuar, kriterëve të përcaktuara në këtë ligj dhe në frymën e tij, duke bërë në rastin në shqyrtim ekuivalimin mes akteve ligjore dhe nënligjore të kohës (1996-2003) dhe asaj çka përmban ligji sot (neni 7/a).
73. Interpretimi i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nuk do të kishte vlerë në kuadër të hetimit të kryer nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, kur ky i fundit është organi i posaçëm që interpreton kriteret ligjore mbi bazë të të cilave vlerësohet përmbushja apo jo e tyre dhe kjo në kontekstin e Nenit 7/a të ligjit 8577/2000, të ndryshuar. (theksojmë këtu dhe se vlerësimi/përzgjedhja e kandidatës si anëtare e KPK bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara nga një tjetër ligj (Ligji 84/2016- b) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor i së drejtës, nëpunës i shërbimit civil në nivel drejtues ose në një përvojë të njohur në fushën e së drejtës administrative ose sfera të tjera të së drejtës.”)
74. Në këto kushte, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerësoi se gjykimi i GJKKO Apel, i sjellë si provë nga kandidatja në mbështetje të pretendimeve të saj, nuk ka forcë detyruese mbi interpretimin që Këshilli i Emërimeve në Drejtësi do të duhet ti bëjë përmbushjes së kriterit të vjetërsisë në punë.
75. Për më tepër, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në vendimin Nr. 12, datë 29.04.2025 (N. Sadedini) vlerësoi se përvoja profesionale si “*pedagoge*” me kohë të pjesshme (part time) për vitet 2008 - 2009, 2009 - 2011, 2022, 2023-2024, 2024 -2025 – 4 vite (pg. 39, faqe 12 e vendimit në renditjen e përvojave profesionale), është konsideruar përvojë jo e vlefshme për efekt kandidimi, me arsyetimin se kandidatja N. S., gjatë kohës që ka ushtruar këtë aktivitet në mësimdhënie nuk ka mbajtur asnjë gradë shkencore nga ato që ka parashikuar ligji nr. 80/2015 “*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*” (shih pg. 85, faqe 31 e vendimit). Në këtë vendim, KED arsyeton se, “*Në interpretim të këtyre dispozitave, del qartë që të konsiderohesh profesor i së drejtës apo lektor*

i saj në kuptim të Nenit 7/a, pika 2, shkronja “a” të ligjit 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, duhet që gjatë kohës që ke ushtruar veprimtari në fushën akademike apo të mësimdhënies pranë institucioneve arsimore të larta, duhet që subjekti të ketë pasur gradën shkencore të kategorisë “profesor”, “doktor”, “profesor i asociuar”, ose të ketë qenë personel akademik i kategorisë “lektor”, sipas përcaktimeve të nenin 59, pika 4 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Në çdo rast tjetër, ushtrimi i aktivitetit të mësimdhënies mund të vlerësohet si një eksperiencë profesionale pune në fushën e arsimit dhe të mësimdhënies që e bën një kandidat jurist të kompletuar dhe të preferuar për pozicione të ndryshme pune, por nuk mund të konsiderohet si eksperiencë profesionale si profesor apo lektor i së drejtës, ose i ekuivalentuar me detyrën e ushtruar si gjyqtar, prokuror, avokat apo i një juristi të nivelit të lartë të administratës publike, që përcaktohet si kusht dhe kriter ligjor në nenin 7/a, pika 2, shkronja “a” të Ligjit Nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, për të kandiduar për anëtar të Gjykatës Kushtetuese. (shih pg. 90, faqe 34 e vendimit).”

76. Sa më sipër, vlerësohet se përvoja profesionale e kandidatës si asistent pedagoge me kohë të plotë në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës NUK mund të konsiderohet eksperiencë profesionale si profesor apo lektor i së drejtës.

- **Sa i përket përvojës profesionale të kandidatës Genta Tafa (Bungo), si Juriste pranë “Debit Collection”shpk,** vlerësohet se kjo përvojë nuk përmbush kërkesat e Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000 mbi përvojën profesionale si “jurist i nivelit të lartë në administratën publike” dhe vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 të KED ku parashikohet se kandidatja të ketë ushtruar një detyrë të nivelit të lartë drejtues në organet e sistemit të drejtësisë apo administratën publike. Debit Collection shpk nuk është organ i sistemit të drejtësisë ose pjesë e administratës publike. Detyrat funksionale nuk përkojnë me kriteret ligjore.
- **Sa i përket përvojës profesionale të kandidatës Genta Tafa (Bungo), si Përmbarues gjyqësor pranë “Speed Solution” shpk** vlerësohet se kjo përvojë nuk përmbush kërkesat e Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000 mbi përvojën profesionale si ‘gjyqtar, prokuror, avokat’ apo dhe “jurist i nivelit të lartë në administratën publike” dhe vendimit Nr. 4, datë 11.03.2019 të KED ku parashikohet se kandidatja të ketë ushtruar një detyrë të nivelit të lartë drejtues në organet e sistemit të drejtësisë apo administratën publike.

77. **Në lidhje me periudhat e vlefshme për kandidim-** Sa i përket përvojës profesionale të kandidatës Genta Tafa (Bungo), si Pedagoge pranë Universitetit Justiniani (2009-2012) vlerësohet se kjo përvojë përmbush pa asnjë dyshim kërkesat e Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000.

78. Parashikimi në nenin e sipërcituar në lidhje me ‘profesor’ apo ‘lektor’ i së drejtës (i tillë me ligjin 99/2016 që ndryshoi ligjin 8577/2000), mbështetet në ligjin e kohës në fuqi për arsimin

e lartë dhe më konkretisht ligji 80/2015 në të cilin personeli akademik kategorizohet në: a) profesorë, b) lektorë (grada shkencore “Doktor”), c) asistent-lektorë (diplomë Master i shkencave) (neni 59). Po sipas këtij ligji (shih nenin 126) personeli akademik, i punësuar në institucionet e arsimit të lartë, i kategorisë “Docent”, në kuadër të përcaktimeve të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007, konsiderohet “Lektor”, ndërsa personeli akademik i kategorisë “Lektor”, konsiderohet “Asistent lektor”. Me Ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007 (në fuqi deri në 2015), personeli i institucionit të arsimit të lartë rigrupohet në: personel akademik, personel ndihmës mësimor - shkencor dhe personel administrativ. Sipas Nenit 47 të këtij ligji, personeli akademik sipas rolit dhe veprimtarisë që kryen kategorizohet në:

1. Profesorë, anëtarë të personelit akademik, titullarë të lëndëve ose moduleve dhe udhëheqës të veprimtarisë së kërkimit shkencor (gradë shkencore “Doktor” dhe titujt akademikë: “Profesor i asociuar”, “Profesor”, “Profesor emeritus” dhe “Akademik),
2. Docentë, anëtarë të personelit akademik që zhvillojnë kryesisht veprimtari mësimore (titull akademik “Docent” ose gradë shkencore “Doktor”) dhe
3. Lektorë, anëtarë të personelit akademikë që zhvillojnë veprimtari mësimore - kërkimore (diplomë Master i Nivelit të Dytë).

79. Në këtë periudhë kohore kandidatja paraqitet/klasifikohet si pedagoge dhe klasifikimi si pedagoge/lektore përputhet me kualifikimin Gradë shkencore “Doktor” në të drejtën publike me nr. 147 diplome, datë 18.06.2008.
80. Sa i përket përvojës profesionale të kandidates Genta Tafa (Bungo), Anëtare/ Kryetare e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, vlerësohet se kjo përvojë përmbush pa asnjë dyshim kërkesat e Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000/funksion kushtetues.
81. Sa i përket përvojës profesionale të kandidates Genta Tafa (Bungo), Drejtor i Drejtorisë Juridike pranë Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit (Ministri që më pas u suksedua nga Ministria e Brendshme, vërtetuar nga urdhëri i lirimit nga detyra) vlerësohet se kjo përvojë përmbush kërkesat e Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, nisur kjo nga natyra e kësaj drejtorie-drejtori juridike, institucioni qëndror – Ministri, si dhe lloji i ministrisë dhe portofoli i kompetencave – (Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe më pas Ministria e Brendshme) si dhe qëllimi dhe përshkrimi i punës konkrete e në veçanti ndjekja e kuadrit ligjor të procesit të decentralizimit dhe të projektakteve në ngarkim. Posaçërisht në këtë fushë kandidatja rezulton të ketë krijuar ekspertizë teknike të cilën e ka zhvilluar dhe më tej me anë të punës akademike.
82. Gjithashtu, kandidatja ka qenë e punësuar si punonjëse akademike/ pedagoge/ lektore në universitete të ndryshme publike/ private që prej vitit 2008 deri me 2017. **Në lidhje me**

eksperiencat e kandidates si lektore/ pedagoge e jashtme pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë Privat, Këshilli vlerësoi si më poshtë:

- a) Pedagoge e jashtme pranë Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, periudha 2012-2013- ka zhvilluar 129 orë mësimi, të përkthyer në një vit të plotë akademik. **Përvojë e vlefshme për kandidim;**
- b) Pedagoge e jashtme pranë Albanian University, periudha mars 2009–qershor 2009 – ka zhvilluar 27 orë mësimi. **Përvojë jo e vlefshme për kandidim** pasi bie ndesh me punësimin si pedagoge me kohë të plotë pranë Universitetit “Justiniani”;
- c) Pedagoge e jashtme pranë Albanian University, periudha tetor 2013–shkurt 2014 – ka zhvilluar 50 orë mësimi, të përkthyer në një semestër akademik. **Përvojë e vlefshme për kandidim³;**
- d) Lektore e ftuar/Udhëheqëse disertacionesh pranë Universitetit European të Tiranës (UET), periudha 2014–pa afat. **Përvojë e vlefshme për kandidim⁴.**
- e) Pedagoge e jashtme pranë Kolegjit “Luarasi”, periudha 2016–2017. **Përvojë e vlefshme për kandidim, nuk bie ndesh me punësim tjetër relevant⁵;**
- f) Pedagoge e jashtme pranë Kolegjit “Luarasi”, periudha 2004–2005. **Përvojë jo e vlefshme për kandidim,** nuk bie ndesh me punësim tjetër relevant, por pa doktoraturë.
- g) Pedagoge e jashtme pranë Kolegjit “Luarasi”, periudha 2005–2006. **Përvojë jo e vlefshme për kandidim,** nuk bie ndesh me punësim tjetër relevant, por pa doktoraturë.
- h) Pedagoge e jashtme pranë Universitetit “Marin Barleti”, periudha 2008–2009, semestri I – ka zhvilluar 28 orë leksion. **Përvojë e vlefshme për kandidim;**
- i) Pedagoge e jashtme pranë Universitetit “Marin Barleti”, periudha 2009–2010, semestri I – ka zhvilluar 15 orë leksion. **Përvojë jo e vlefshme për kandidim** pasi bie ndesh me punësim tjetër relevant me kohë të plotë (pedagoge e brendshme tek “Justiniani”);
- j) Pedagoge e jashtme pranë Universitetit “Kristal”, periudha mars–maj dhe tetor–dhjetor 2007 – **Përvojë jo e vlefshme për kandidim,** nuk bie ndesh me punësim tjetër relevant, por pa doktoraturë⁶

³ Periudhe e vlefshme për kandidim është semestri i I, tetor-shkurt i cili do të përkthehet në 5 muaj kalendarike, ose një semestër akademik.

⁴ Kandidatja ka parashtruar se angazhimi i saj për udhëheqjen e doktoraturave ka qenë 80 orë/ për doktorant. Duke marrë parasysh që doktorantet e udhëhequr kanë përfunduar në vitet 2015-2016 dhe 2021, dy të parët janë në periudha të cilat nuk bien ndesh me punësim tjetër. Në këto kushte 80 orë x2 kandidate= 160 orë mesimore, duke marrë 120 orë si maksimumin vjetor të orëve të një pedagogu të jashtëm, kjo periudhë do të llogaritet si 1 vit kalendarik. Ose një vit e 3 muaj akademik.

⁵ Sipas vërtetimit të fundit sjellë nga kandidatja, Universiteti Luarasi vërteton se kandidatja ka qenë e angazhuar për 60 orë mesimore në vitin akademik 2016-2017. Duke qenë se 60- orë janë gjysma e orëve vjetore të një pedagogu të jashtëm, kjo periudhë do të përloget si një semestër.

⁶ Për këtë eksperiencë kandidatja ka sjellë si provë statement bankar ku ka evidentuar pagesat nga Kristal Shpk, në kushtet kur ky institucion i Arsimit të Lartë është mbyllur dhe as kandidatja as KED nuk ka mundur të kërkojë informacion.

- k) Pedagoge e jashtme pranë Universitetit “Kristal”, periudha shtator–nëntor–dhjetor 2008⁷ – **Përvojë e vlefshme për kandidim**, nuk bie ndesh me punësim tjetër relevant dhe me doktoraturë⁸;
- l) Pedagoge e jashtme pranë Universitetit “Justicia”, periudha tetor 2009 – **Përvojë jo e vlefshme për kandidim** pasi bie ndesh me punësim tjetër relevant. (pedagoge e brendshme tek “Justiniani”);
- m) Pedagoge e jashtme pranë Universitetit “Justicia”, periudha shkurt 2011 – **Përvojë jo e vlefshme për kandidim** pasi bie ndesh me punësim tjetër relevant. (pedagoge e brendshme tek “Justiniani”).

83. Në lidhje me këto periudha, përllogaritja e orëve dhe semestrave të angazhimit është bërë në mbështetje të Ligjit 80/2015 dhe akteve nënligjore të nxjerra në vijim, në të cilat përcaktohet ngarkesa maksimale e një pedagogu të jashtëm në vlerën e 120 orëve mësimore.
84. Në përfundim pas diskutimit të anëtarëve, Këshilli vlerësoi **vjetërsinë në punë** të kandidatës sipas periudhave më poshtë:

Me kohë të plotë: 1 vit, 5 muaj, 22 ditë (Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit), 3 vjet, 2 muaj (Universiteti Justiniani I), 7 vjet, 6 muaj e 14 ditë (Komisioni i Pavarur i Kualifikimit)- në total 12 vite, 2 muaj, 14 ditë

Me kohë të pjesshme- 9 muaj (Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”), 5 muaj (Albanian University), 12 muaj (UET), 4,5 muaj (Kolegjit “Luarasi”), 4,5 muaj (Universiteti “Marin Barleti”), 3 muaj (Universiteti Kristal)- në total 38 muaj, ose 3 vite e 2 muaj

85. Për mënyrën e përllogaritjes mbahet në vëmendje parashikimi i Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000 mbi përvojën profesionale dhe Vendimi Nr. 4, datë 11.03.2019 i KED ku parashikohet se kandidati të ketë ushtruar një detyrë të nivelit të lartë drejtues në organet e sistemit të drejtësisë apo administratën publike.
86. Për sa më lart, në zbatim të pikës 4 të Nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezulton i provuar fakti se kandidatja Genta Tafa (Bungo) ka **15 vite, 4 muaj e 14 ditë** vjetërsi pune. Konkretisht, për periudhat e saktësuara si më poshtë:

- i. *Drejtor i Drejtorisë Juridike pranë Ministrisë së Brendshme (ish Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit) nga data 01.07.2004 deri në datë 23.12.2005 – periudha e punësimit 1 (një) vit, 5 (pesë) muaj e 22 (njëzet e dy ditë) ditë.*
- ii. *Pedagoge në Universitetin “Justiniani” shpk nga data 01.01.2009 deri në datë 29.02.2012 – periudha e punësimit 3 (tre) vjet, 2 (dy) muaj.*

⁷ Periudha e përllogaritjes është 3 muaj duke u nisur nga pagesat e referuara nga kandidatja në muajt shtator, nëntor, dhjetor.

⁸ Kandidatja ka fituar gradën Doktor në 18.06.2008.

- iii. *Komisionere/ Kryetare pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nga data 17.06.2017 - 31.12.2024- periudha e punësimit 7 (shtatë) vjet, 6 (gjashtë) muaj e 14 (katërmbëdhjetë) ditë.*
 - iv. *Pedagoge me kohë të pjesshme, pranë Universiteteve Private, nga viti 2008 deri në vitin 2017, periudha e punësimit 3 (tre) vite e 2 (dy) muaj.*
87. Bazuar në gjetjet e sipërcituara, Këshilli konstaton se kandidati ka ushtruar së paku për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht për lejimin e kandidimit nga pika 4 e Nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000 dhe për rrjedhojë kandidati Genta Tafa/Bungo nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.
88. Në pikën 5 të Nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronjës “c” të pikës 1 të Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, përcaktohet që kandidati të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike gjatë 10 viteve të fundit dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit.
Sikurse parashtrohet më sipër, si edhe nga jetëshkrimi dhe aktet e administruara në dosjen e kandidimit për veprimtaritë e tjera të ushtruara, Këshilli konstaton se, kandidati nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike gjatë periudhës së përcaktuar nga ligji dhe se kandidati nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë periudhës së përcaktuar nga ligji. Për rrjedhojë kandidati Genta Tafa (Bungo) nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.
89. Në shkronjën “d” të pikës 1 të Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, si kusht kandidimi përcaktohet që kandidati të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi. Nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, Këshilli konstaton se kandidati nuk rezulton të jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore. Po kështu, nuk rezulton që kandidati të ketë masa disiplinore në fuqi. Për rrjedhojë kandidati Genta Tafa (Bungo) nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.
90. Në pikën 4 të Nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronjën “b” të pikës 1 të Nenit 7/a të Ligjit Nr. 8577/2000, parashikohet që kandidati të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë. Nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidati ka përfunduar studimet në periudhën 1989-1993, duke u diplomuar në datë 28.09.1993 me titullin “Jurist”. Në zbatim të Nenit 75 dhe 124 të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë. Për rrjedhojë kandidati Genta Tafa (Bungo) nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.
91. Në këto kushte, në mbledhjen e datës **15.07.2025** Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, vendosi:

Vijimin e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit të Znj. Genta Bungo, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë e Shqipërisë në datën 11.12.2024.

C. Procesi i deklarimit dhe kontrollit të integritetit të kandidatit.

92. Në kuadër të kontrollit për verifikimin e kriterit të integritetit të kandidatit, nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi është kërkuar informacion në të gjitha organet ligjzbatuese, të cilat kanë përcjellë përpara Këshillit në rrugë zyrtare të gjithë informacionin përkatës.
93. Në datë 20.01.2025, kandidatja **Genta Tafa (Bungo)**, u paraqit pranë KED dhe tërhoqi për plotësim formularët standard të deklarimit dhe autorizimet e duhura për procedurën e aplikimit për plotësimin e vendit vakant, objekt i kësaj procedure verifikimi, midis të cilave edhe ato për deklarimin e pasurisë dhe interesave financiarë. Në datë 22.01.2025, dhe 24.01.2025 kandidatja është paraqitur pranë KED për dorëzimin e autorizimeve dhe deklarimeve përkatëse.
94. Gjatë kësaj periudhe ndërmjet Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe institucioneve publike e private janë shkëmbyer zyrtarisht shkresa me kërkesa dhe përgjigje në lidhje me vlerësimin e kandidates për kriterin e pasurisë dhe kushteve të tjera ligjore, për të cilat është njoftuar kandidatja, që gjithashtu ka reaguar duke dërguar informacione shtesë dhe parashtresa.
95. Në mbledhjen e datës 15.07.2025, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi konkludoi me vijimin e procedurës së verifikimit për kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit të znj.Tafa (Bungo).
96. Për të kryer verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të Ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, pika e 82 e vijuese të tij, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka kryer dërgimin e një korrespondencë të gjerë me disa institucione shtetërore në lidhje me marrjen e të dhënave që verifikojnë pastërtinë e figurës dhe integritetin e kandidates Genta Tafa, e konkretisht me këto institucione shtetërore: (1) Autoritetit për Informim mbi dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH); (2) Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve; (3) Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit; (4) Autoriteti Kombëtar për Sigurimin e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK); (5) Prokurorisë së Përgjithshme; (6) Ministrisë së Brendshme, Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (AMP); (7) Prokurorisë e Përgjithshme, Drejtorisë së Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë; (8) Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile; (9) Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; (10) Gjykatës së Posaçme Shkallës së Parë Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit; (11) Gjykatës së Posaçme të Apelit Kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit; (12) Gjykatës së Lartë; (13) Gjykatës së Apelit të Juridiksionit

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al; Numra telefonikë : +355 4 2257302

të Përgjithshëm; (14) Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

97. Me shkresën nr. 66 prot., datë 31.01.2025 dhe shkresën nr. 74, datë 31.01.2025, Këshilli Emërimeve në Drejtësi ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidatja Genta Tafa (Bungo), me datë 21.01.2025 sipas ligjit nr. 138/2015.
98. Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë, në përgjigjen e kthyer me shkresën nr. 206/11 prot., datë 12.02.2025, ka informuar Këshillin e Emërimeve në Drejtësi se për kandidaten Genta Bungo (Tafa): “...nga kontrolli i kryer në sistemin elektronik IMPRO.... i cili përmban të dhëna nga viti 2015 e në vazhdim ..., nuk rezulton asnjë praktikë e regjistruar në sistemin IMPRO”.
99. Nga ana e Drejtorisë së Koordinimit Institucional, Sektori i Dekriminalizimit të Prokurorisë së Përgjithshme, me shkresën nr. 206/2 prot., datë 05.02.2025, është bërë me dije, si vijon: “...Prokuroria e Përgjithshme kryen verifikimin e thelluar të të dhënave të vetëdeklaruar në formularin e plotësuar nga subjekt të këtij ligji, bazuar në kërkesën e bërë brenda 5 ditëve nga organi përgjegjës, për administrimin e formularit të vetëdeklarimit, vetëm për rastet kur ky i fundit, pas shqyrtimit dhe verifikimit paraprak të të dhënave, konstaton se:
- *subjekti/personi nuk ka deklaruar në formular asnjë fakt që ka të bëjë me të kaluarën e tyre penale, por ka indicie mbi bazën e një kërkesë, ose kryesisht kur ka të dhëna apo fakte, përfshirë ato të njohura botërisht për ekzistencën e të dhënave që kanë të bëjnë me....*
 - *subjekti/personi ka deklaruar në formular të dhëna që kanë të bëjnë me rrethanat/faktet e sipërpërmendura dhe se prima facia të dhënat nuk përfshihen brenda sferës së ndalimeve, të parashikuara nga neni 2, i ligjit nr. 138/2015, por e kalon rastin për kontroll të thelluar, për të verifikuar saktësinë e të dhënave të pasqyruara dhe për të konstatuar nëse rrethanat janë të ndryshme dhe se personi është subjekt i ndalimeve, sipas ligjit;*
 - *ka kërkesë të bërë pranë tij, si organ kompetent për verifikim të të dhënave në formularin e vetëdeklarimit të parashikuar në nenin 5 të këtij ligji, nga një prej subjekteve që gëzojnë të drejtën e nismës për verifikimin e të dhënave, sipas nenit 7, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Sipas kësaj dispozite, për anëtarin e Gjykatës Kushtetuese, të drejtën e nismës për të kërkuar verifikimin e të dhënave, pranë organit kompetent për verifikim, sipas këtij ligji, e ka 1/10 e deputetëve, Kryetari i Kuvendit, Kryeministri dhe Prokurori i Përgjithshëm. Në këtë rast, organi përgjegjës dhe kompetent, për administrimin e formularit dhe verifikimin paraprak të të dhënave, në kërkesën për verifikim të thelluar specifikon subjektin e nenit 7 të ligjit nr. 138/2015 që ka kërkuar verifikimin dhe të dhënat, faktet apo rrethanat që përmban kërkesa e tij e që përbëjnë shkak për zbatimin e këtij ligji.....Për sa më sipër, mbështetur në nenet 44, 62 e 64 të Kodit të Procedurave Administrative, ju kërkohet plotësimi i pasaktësive/ të metave brenda njëzetë ditëve. Mosplotësimi i tyre brenda afatit të caktuar përbën shkak për mospranimin e kërkesës”.*

100. Në vijim të shkresës nr. 206/2 prot., datë 05.02.2025 të Prokurorisë së Përgjithshme, është përcjell nga ky institucion me shkresën nr. 206/17 prot., datë 07.03.2025, vendimi i datës 07.03.2025 “Për mospranimin e kërkesës” ku është vendosur:

“1. Mospranimin e kërkesës nr.66 prot., datë 31.01.2025, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për verifikimin e plotë të të dhënave të pasqyruara në formularin e vetedeklarimit datë 20.01.2025 në zbatim të ligjit nr. 138/2015, nga Genta Leka Tafa, kandidat për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

2. Ky vendim t'i njoftohet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kundër të cilit mund të ankohet sipas procedurës së parashikuar në Kodin e Procedurave Administrative”.

101. Për verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatës Genta Tafa (Bungo), në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, si edhe në zbatim të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe Kreut II e V-së të Vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si organi kompetent i administrimit të vetëdeklarimeve dhe zbatimin e ndalimeve për kandidaten, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i ka kërkuar informacion:

a. me shkresën nr. 68 prot., datë 31.01.2025, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, e cila me shkresën nr. 543/4 prot., datë 10.02.2025, ka kthyer përgjigje në lidhje me kandidaten Genta Bungo (Tafa) se: *“Nga verifikimet e kryera rezultoi se shtetasit.... nuk janë ndaluar apo arrestuar në flagrancë nga strukturat e Policisë së Shtetit për kryerjen e ndonjë veprë penale; nuk figurojnë të regjistruar me identitet tjetër; nuk rezultojnë të kthyer deportiv apo të dëbuar nga territori i ndonjë shteti tjetër; nuk rezultojnë të kenë urdhër kërkimi ndërkombëtar nga ndonjë autoritet gjyqësor i huaj”*

b. me shkresën nr. 69 prot., datë 31.01.2025, Këshilli i ka dërguar, formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidatja Genta Tafa (Bungo), për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit. Ky i fundit pas kontrollit të ushtruar, me shkresën nr. 222/3 prot., datë 14.02.2025, i ka përcjellë, në Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, vendimin nr. 71, datë 14.02.2025, me të cilën është konkluduar se:

“ , znj. Genta Tafa (Bungo) nuk rezultojnë se kanë qenë persona në ndjekje për spiunazh apo terrorizëm; Nuk kanë qenë bashkëpunëtor anëtar ose të favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit. Nuk figurojnë në dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, deri në 2 korrik 1991, sipas përcaktimeve të Nenit 29, pika 2 Ligjit Nr.45/2015, "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë" i ndryshuar.”.

- c. me shkresën nr. 70 prot., datë 31.01.2025, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila me shkresën nr. 1616/1 prot., datë 07.02.2025, ka bashkëlidhur vërtetimin e gjendjes gjyqësore për kandidaten me datë 05.02.2025 dhe ka kthyer përgjigje se: “...rezultojnë pa shënime në sistem...”;
- d. me shkresën nr. 72 prot., datë 31.01.2025, Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (ish Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave) pranë Ministrisë së Brendshme, e cila me shkresën nr. 658/1 prot., datë 11.02.2025 ka informuar se: “ *Nuk ka të dhëna për kontakte apo lidhje të tyre me persona të papërshtatshëm apo të përfshirë në krimin e organizuar*”.
- e. me shkresën nr. 73 prot., datë 31.01.2024, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, e cila me shkresën nr. 1166/1 prot., datë 12.02.2025, ka informuar se kandidatja: “*Ka ndryshuar mbiemrin nga Bungo në Tafa në martesë*”.
102. Gjatë procesit të verifikimit të kryer në zbatim të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 e nenit 237 të Ligjit nr. 115/2016, të pikave 79-87 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, si edhe në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut II e V-së të Vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Shqipërisë “*Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për këtë kandidate:
- nuk ka konstatuar asnjë të dhënë apo fakt, indicie mbi bazën e një kërkesë, përfshirë ato të njohura botërisht për ekzistencën e të dhënave që kanë të bëjnë me:
 - dënime penale me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
 - dënime penale me vendim jopërfundimtar nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-ve, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;
 - masë sigurimi personal nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-ve, Kanadasë, Australisë, apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;
 - urdhër kërkimi ndërkombëtar nga një autoritet gjyqësor i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-ve, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit;
 - dëbime nga territori i një shteti anëtar të BE-së, SHBA-ve, Kanadasë, Australisë apo një shteti tjetër të përcaktuar me vendim të Kuvendit.
 - nuk ka konstatuar të deklaruar në formular të dhëna që kanë të bëjnë me faktet e sipërpërmendura apo të dhëna që *prima facie* të përfshihen brenda sferës së ndalimeve, të parashikuara nga neni 2, i ligjit nr. 138/2015;
 - nuk ka konstatuar që të jetë kërkuar, nga një prej subjekteve që gëzojnë të drejtën e nismës, për verifikimin e të dhënave në Formularin e Vetëdeklarimit, sipas nenit 7, të ligjit nr. 138/2015 “*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike*”.

i. Kontrolli mbi gjendjen gjyqësore dhe proceset penale të regjistruar ndaj kandidates (neni 7/a, pika 1 germa “ç” i ligjit nr. 8577/2000)

103. Për verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidates Genta Tafa Bungo, sikurse është cituar dhe më sipër, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, ka vijuar korrespondencën me institucionet përkatëse si më poshtë:
104. Në vijim të shkresës nr. 66 prot., datë 31.01.2025 të KED, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme me shkresën nr. 206/44 prot., datë 29.04.2025 është përcjell verifikimi i kryer nga prokuroritë e rretheve, ku evidentohet si vijon:
- Me shkresën nr. 1815/1 prot., datë 25.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, lidhur me kandidaten referon se: “*Nuk rezulton të jetë regjistruar kallëzime/referime/procedime penale; Nuk rezulton i regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprës penale si person i dyshuar; Nuk është ndaluar apo arrestuar në flagrance; Nuk i është caktuar ndonjë masë sigurimi personal*”
 - Me shkresën nr. 1068/1 prot., datë 25.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, lidhur me kandidaten referon: “*... nuk është në hetim, apo i dënuar për kryerjen e ndonjë veprë penale në Prokurorinë Dibër*”.
 - Me shkresën nr. 1383 prot., datë 25.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, lidhur me kandidaten referon se: “*.. nuk rezulton në hetim apo i dënuar me vendim të formës së prerë*”.
 - Me shkresën nr. 4377/1 prot., datë 28.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, lidhur me kandidaten referon se: “*nga verifikimet i kryer nga zyra e regjistrit dhe zyra e arkivës nuk rezulton të jetë regjistruar material kallëzues apo procedim penal..*”.
 - Me shkresën nr. 1383 prot., datë 25.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, lidhur me kandidaten referon se: “*nuk rezulton në hetim, apo i dënuar me vendim të formës së prerë*”.
 - Me shkresën nr. 1297 prot., datë 28.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, lidhur me kandidaten referon se: “*Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi; Nuk është kërkuar masë sigurimi personal; Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim; Nuk ka pasur regjistrim të njoftimit të veprave penale; Nuk ka pasur rast të urdhërave ndërkombëtar të ndalimit*”.

- Me shkresën nr. 4233 prot., datë 28.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, lidhur me kandidaten referon se: “*Nuk ka filluar ndjekje penale dhe nuk janë dënuar me vendim të formës së prerë me kërkesën e kësaj Prokurorie*”.
- Me e-mail të datës 29.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë ka referuar se: “*pas verifikimeve të bëra në regjistrat e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, nuk rezulton të jenë në hetim, apo jetë dhënë vendim gjykatë jo përfundimtar apo i formës së prerë për kryerjen e ndonjë veprë penale brenda territorit Republikës së Shqipërisë apo jashtë shtetit, në ngarkim të shtetasve sipas listës emërore, cituar në kërkesën.*”
- Me shkresën nr. 7343 prot., datë 29.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, lidhur me kandidaten referon se: “*Nuk figuron të ketë të regjistruar kallëzime/procedime penale në emër të këtyre shtetasve.*”
- Me shkresën nr. 2513 prot., datë 28.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, lidhur me kandidaten referon se: “*nuk rezulton të jenë në hetim dhe nuk rezulton të jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë veprë penale*”.
- Me shkresën nr. 1862/1 prot., datë 29.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, lidhur me kandidaten referon se: “*nuk është regjistruar asnjë procedim penal ndaj shtetasve*”.
- Me shkresën nr. 5380/1 prot., datë 25.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, lidhur me kandidaten referon se: “*Prokuroria nuk ka në hetim apo të jenë dënuar me vendim të formës së prerë*”.
- Me shkresën nr. 3528 prot., datë 25.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, lidhur me kandidaten referon se: “*nuk rezulton të jenë në hetim apo të jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e ndonjë veprë penale.*”
- Me shkresën nr. 11061/1 prot., datë 25.04.2025, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, lidhur me kandidaten referon se: “*Nga verifikimi i kryer në indekset e kallëzimeve dhe statistikave të procedimeve penale për periudhën kohore vitet 2022-2025, nuk rezultoi të ketë procedim penal të regjistruar në ngarkim të shtetasve të lartpërmendur*”.

105. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED) me shkresat nr. 75 prot., dhe nr. 91 prot., datë 31.01.2025, ka kërkuar informacion pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë Për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykatës së Lartë. Në lidhje me kandidaten Genta Tafa (Bungo) gjykatat kanë përcjell informacionin vijues:

- Me shkresën nr. 611/1 prot., datë 10.02.2025, Gjykata e Lartë ka referuar se: “... nuk rezulton që pranë kësaj gjykate të ketë të regjistruar çështje penale”
- Me shkresën nr. 183/1 prot., datë ska, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka referuar se: “..a. Nuk rezulton të jetë regjistruar për shqyrtim asnjë çështje penale në ngarkim; b. Nuk janë dhënë vendime penale qoftë të formës së prerë, apo jo;
- Me shkresën nr. 396/1 prot., datë 10.02.2025, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, ka referuar se: “nuk janë dhënë vendime penale si dhe aktualisht nuk ka çështje penale në gjykim;
- Me shkresën nr. 2283/1 prot., datë 04.02.2025, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm ka referuar se: “...për periudhën 2007-02.02.2025, nuk rezultojnë të regjistruara për shqyrtim/gjykuara çështje penale;
- Me shkresën nr. 114/1 prot., datë 04.02.2025 Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Dibrë ka referuar se: nuk ka pasur çështje penale si dhe nuk ka vendim penal të formës prerë ose jo”;
- Me shkresën nr. 212/1 prot., datë 04.02.2025 Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat ka referuar se: “në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS) nuk rezulton çështje penale e regjistruar”;
- Me shkresën nr. 547/1 prot., datë 07.02.2025, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka referuar se: “...nuk rezultojnë të ketë qenë apo të jetë aktualisht si palë ndërgjyqëse në vendime apo procese gjyqësore”;
- Me shkresën nr. 225/1 prot., datë 04.02.2025, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan ka referuar se: “..nuk rezulton të ketë marrë cilësinë e personit nën hetim në një procedimin penal, apo të jetë marrë vendim për të zbatuar/revokuar/shuarje mase sigurimi me karakter personal ose pasuror, apo të kenë procedime penale të mosfilluara, të pushuara apo të pezulluara vendime dënimi apo pafajësie”;
- Me shkresën nr. 1070/1 prot., datë 05.02.2025, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Fier ka referuar se: “Nuk rezulton të jenë regjistruar çështje penale apo të jenë dhënë vendime penale pranë kësaj gjykate apo të ketë çështje për shqyrtim”;
- Me shkresën nr. 27 prot., datë 27.02.2025, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë ka referuar se: “..nuk është proceduar pranë asaj gjykate”;
- Me shkresën nr. 464/1 prot., datë 10.02.2025, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë ka referuar se: “..nga verifikimi i sistemit ICMIS nuk rezulton asnjë çështje gjyqësore”;
- Me shkresën nr. 162/1 prot., datë 10.02.2025, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës ka referuar se: “ nuk rezulton të ketë proces

penal, të jetë duke u verifikuar, marr vendim zbatuar/revokuar/shuar masë sigurimi me karakter personal ose pasuror, apo të kenë vendime dënimi apo pafajësie”;

- Me shkresën nr. 109/1 prot., datë 06.02.2025, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë ka referuar se: “*..nuk rezulton të ketë të dhëna për procedime penale të filluara apo vendime penale të formës së prerë ose jo”;*
- Me shkresën nr. 89/1 prot., datë 07.02.2025, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë ka referuar se: “*nuk ka asnjë çështje të regjistruar apo vendim të dhënë”;*
- Me shkresën nr. 211/1 prot., datë 10.02.2025, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër ka referuar se: “*...Nga kërkimi i indekseve dhe sistemeve,—nuk rezulton të ketë patur të regjistruar çështje penale nuk rezulton të jenë dhënë vendime penale”*, duke sjell në vëmendje se ky informacion nuk përmban të dhëna mbi çështje që përbëjnë sekret hetimor (përgjime apo gjykime të kësaj kategorie) si dhe vendime penale të gjykatës me objekt "Pushimin e çështjes penale", kur subjektit nuk i është regjistruar emri në regjistrin e procedimeve (gjykime paraprake me objekt "Pushimin e procedimit penal nr.../ viti"), pasi nuk regjistrohet emri as në sistemet e gjykatës apo regjistrat e saj;
- Me shkresën nr. 467/3 prot., datë 19.02.2025, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm ka referuar se: “*Nga verifikimi realizuar në Sistemin e Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore Penale për periudhën viti 2002 (vit kur fillon Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore Penal) deri në datën e kësaj shkrese, nuk rezulton të jetë regjistruar ose dhënë ndonjë vendim themeli penale / masa sigurimi në ngarkim”*
- Me shkresën nr. 599/1, datë 11.02.2025, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë ka referuar se: “*Nga verifikimi i kryer në Sistemin Informatik të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS), dhe verifikimi i kryer në indeksat penale të administruara pranë Zyrës së Arkivës, nuk rezulton të jetë dhënë vendim penal i formës së prerë apo të jetë regjistruar për shqyrtim çështje penale”*.

106. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi (KED), me shkresën nr. 71 prot., datë 31.01.2025, i ka kërkuar informacion dhe Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (në vijim SPAK), e cila, me shkresën nr. 7717 prot., datë 28.02.2025, ka kthyer përgjigje se:

“Në përgjigje të shkresës suaj, me nr.71 prot, datë 31.01.2025, dhe në vijim tonës me Nr. 7717, datë 28.02.2025, ju konfirmojmë se pas verifikimeve të kryera në regjistrin e procedimeve penale të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, nuk rezulton që të jetë regjistruar ndonjë procedim penal në ngarkim të kandidatëve... Genta Leka Tafa, Pas verifikimeve të kryera në regjistrin e kallëzimeve, në lidhje me shtetasen Genta Tafa rezultojnë këto të dhëna:

- është regjistruar kallëzimi **Nr.259, i vitit 2020**. Pas kryerjes së verifikimeve në lidhje me këtë kallëzim është vendosur mosfillim procedimi më datë 07.01.2021(bashkëlidhur vendimi).
- është regjistruar kallëzimi **Nr.35, i vitit 2021**. Pas kryerjes së verifikimeve në lidhje me këtë kallëzim është vendosur mosfillim procedimi më datë 23.02.2021(bashkëlidhur vendimi).
- është regjistruar kallëzimi **Nr.42, i vitit 2021**. Pas kryerjes së verifikimeve në lidhje me këtë kallëzim është vendosur mosfillim procedimi më datë 08.03.2021(bashkëlidhur vendimi)..
- është regjistruar kallëzimi **Nr.72, i vitit 2021**. Pas kryerjes së verifikimeve në lidhje me këtë kallëzim është vendosur mosfillim procedimi më datë 29.03.2021(bashkëlidhur vendimi)..
- është regjistruar kallëzimi **Nr.200, i vitit 2021**. Pas kryerjes së verifikimeve në lidhje me këtë kallëzim është vendosur mosfillim procedimi më datë 30.06.2021(bashkëlidhur vendimi)..
- është regjistruar kallëzimi **Nr.274, i vitit 2021**. Pas kryerjes së verifikimeve në lidhje me këtë kallëzim është vendosur mosfillim procedimi më datë 13.09.2021(bashkëlidhur vendimi)..
- është regjistruar kallëzimi **Nr.168, i vitit 2022**. Pas kryerjes së verifikimeve në lidhje me këtë kallëzim është vendosur mosfillim procedimi më datë 29.12.2022 (bashkëlidhur vendimi).

107. Në përgjigje të një kërkesë të dytë nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në lidhje me ankimet ndaj vendimeve të mosfillimit të procedimit, Prokuroria Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar nëpërmjet shkresës Nr.13137 Prot., datë 16.04.2025, ka informuar si më poshtë:

“ Në lidhje me shtetasen Genta Tafa, rezultojnë këto të dhëna :

- është regjistruar kallëzimi **Nr.259, i vitit 2020**. Pas kryerjes së verifikimeve në lidhje me këtë kallëzim është vendosur mosfillim procedimi më datë 07.01.2021. Ndaj vendimit të mosfillimit është ushtruar ankim nga ana e kallëzueses. Me vendimin Nr.35 datë 02.03.2021, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur mospranimin e ankimit të kallëzueses. Ndaj vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë është ushtruar ankim nga ana e kallëzueses në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila me vendimin Nr.108, datë 20.04.2021 ka vendosur miratimin e vendimit Nr. Nr.35 datë 02.03.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Kundër vendimit Nr. 108, datë 20.04.2021 është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë e cila me vendimin Nr.00-2024-1710 ka vendosur mospranimin e rekursit nga ana e kërkesuesit;
- është regjistruar kallëzimi **Nr.35, i vitit 2021**. Pas kryerjes së verifikimeve në lidhje me këtë kallëzim është vendosur mosfillim procedimi më datë 23.02.2021.Ndaj vendimit të mosfillimit është ushtruar ankim nga ana e kallëzuesit. Me vendimin Nr.

180 datë 28.06.2021, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të mosfillimit të Prokurorisë së Posaçme. Ndaj vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë është ushtruar ankim nga ana e kallëzuesit në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar e cila me vendimin Nr.207, datë 27.09.2021 ka vendosur miratimin e vendimit Nr. 180 datë 28.06.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;

- është regjistruar kallëzimi **Nr.42, i vitit 2021**. Pas kryerjes së verifikimeve në lidhje me këtë kallëzim është vendosur mosfillim procedimi më datë 08.03.2021.Ndaj vendimit të mosfillimit është ushtruar ankim nga ana e kallëzuesit. Me vendimin Nr.230 datë 26.07.2021, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur rrëzimin e ankimit të kallëzuesit kundër vendimit të mosfillimit të Prokurorisë së Posaçme. Ndaj vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë është ushtruar ankim nga ana e kallëzuesit në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila me vendimin Nr.237, datë 29.10.2021 ka vendosur miratimin e vendimit Nr.230 datë 26.07.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.;
- është regjistruar kallëzimi **Nr.72, i vitit 2021**. Pas kryerjes së verifikimeve në lidhje me këtë kallëzim është vendosur mosfillim procedimi më datë 29.03.2021.Ndaj vendimit të mosfillimit është ushtruar ankim nga ana e kallëzueses. Me vendimin Nr.123 datë 03.06.2021, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur rrëzimin e ankimit të kallëzueses. Ndaj vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë është ushtruar ankim nga ana e kallëzueses, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila me vendimin Nr.177, datë 21.07.2021 ka vendosur miratimin e vendimit Nr.123 datë 03.06.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- është regjistruar kallëzimi **Nr.200, i vitit 2021**. Pas kryerjes së verifikimeve në lidhje me këtë kallëzim është vendosur mosfillim procedimi më datë 30.06.2021. Ndaj vendimit të mosfillimit është ushtruar ankim nga ana e kallëzuesit. Me vendimin Nr.279 datë 16.09.2021, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur rrëzimin e ankimit të kallëzueses. Ndaj vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë është ushtruar ankim nga ana e kallëzuesit në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar e cila me vendimin Nr.249, datë 19.11.2021 ka vendosur miratimin e vendimit Nr.279 datë 16.09.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;
- është regjistruar kallëzimi **Nr.274, i vitit 2021**. Pas kryerjes së verifikimeve në lidhje me këtë kallëzim është vendosur mosfillim procedimi më datë 13.09.2021.Ndaj vendimit të mosfillimit është ushtruar ankim nga ana e kallëzuesit. Me vendimin

Nr.358 datë 01.11.2021, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur rrëzimin e ankimit të kallëzuesit. Ndaj vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë është ushtruar ankim nga ana e kallëzuesit në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila me vendimin Nr.272, datë 28.12.2021 ka vendosur miratimin e vendimit Nr.358 datë 01.11.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.;

- është regjistruar kallëzimi **Nr.168, i vitit 2022**. Pas kryerjes së verifikimeve në lidhje me këtë kallëzim është vendosur mosfillim procedimi më datë 29.12.2022. Ndaj vendimit të mosfillimit është ushtruar ankim nga ana e kallëzuesit. Me vendimin Nr.29, datë 20.02.2023, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar ka vendosur rrëzimin e ankimit të kallëzuesit. Ndaj vendimit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë është ushtruar ankim nga ana e kallëzuesit në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, e cila me vendimin Nr.76 datë 18.05.2023 ka vendosur miratimin e vendimit Nr.29, datë 20.02.2023, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.”

108. Gjithashtu, pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në datën 04.03.2025, është paraqitur një dosje me përshkrimin: Informacion mbi përzgjedhjen e kandidatëve për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nga shtetasi E.A., sipas të cilit kandidatja Genta Tafa (Bungo) ka një procedim disiplinor të pashqyrtuar nga KPA. Në lidhje me këtë, në përgjigje të kërkesës së KED-së, me shkresën Nr. 592/1 Prot. datë 06.05.2025 Kolegji i Posaçëm i Apelit ka informuar se: nuk është regjistruar asnjë kërkesë për fillimin e hetimit disiplinor, në kuadër të parashikimit të nenit 17, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" dhe, si rrjedhojë, nuk rezulton të ketë masë disiplinore gjatë vijueshmërisë së marrëdhënies së punës për ish-Komisionerët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ... Genta Tafa (Bungo) ”.
109. Në vijim z. E.A ka denoncuar lidhjet e dyshuara të kandidates për bashkëpunim me një trafikant ndërkombëtar droge për të cilën shprehet se ka vënë në dijeni Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ai gjithashtu përmend në parashtrimet e tij kallëzimet e shumta që ka bërë për kandidaten.
110. Këto të fundit figurojnë të verifikuara dhe të ezauruara në rrugë gjyqësore edhe nga ana e Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (shiko paragrafët 106-107). Posaçërisht z. E.A ka qenë kallëzuesi në kallëzimin 259/2021, 42/2021, 200/2021, 274/2021.
111. Kallëzimet e tjera përkatësisht me nr. 35/2021, janë kryer nga kallëzuesit A.A dhe V.A (vëllai i z. E.A dhe bashkëshortja e tij). Kallëzimi nr.168/2022 nga A. LL dhe G. Y si dhe kallëzimi nr. 72/2021 nga R.Gj.

112. Në vijim të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidates Genta Bungo Tafa, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi iu ka kërkuar informacion, me shkresën nr. 72 prot., datë 31.01.2025 Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore (ish-Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave) pranë Ministrisë së Brendshme.
113. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore (ish-Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave) pranë Ministrisë së Brendshme, me shkresën nr. 658/1 prot., datë 11.02.2025 ka evidentuar se: “*Nuk ka të dhëna për kontakte apo lidhje me persona të papërshtatshëm apo të përfshirë në krimin e organizuar*”.
114. Në vijim të verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidates Genta Tafa (Bungo), në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të Ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4 datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi i ka kërkuar informacion, me shkresën nr. 67 prot., datë 31.01.2025 Autoritetit Kombëtar Për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar i cili ka informacionin përkatës në lidhje me kandidaten.
115. Në lidhje me këtë informacion nga ana e Këshillit u kryen verifikimet e mëtejshme pranë institucioneve përkatëse shtetërore si dhe u morën të dhëna edhe nga Prokuroria e Posaçme.
116. Në mbledhjen e datës 28.07.2025, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi mori në shqyrtim sa më lart.

➤ Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

117. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi në lidhje me kriterin e tretë që lidhet me verifikimin e pastërtisë së figurës dhe integritetit të kandidatit, pasi mori në shqyrtim të detajuar të gjithë korrespondencat e kryera me institucionet e treta me rol ndihmës në këtë proces, si dhe të dhënat që ato kanë pasqyruar, arrin në konkluzionin se procedura e kryer në lidhje me verifikimin e këtij kriteri është e plotë, e gjithanshme dhe shteruese.
118. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vlerëson se ushtrimi i funksionit të tij verifikues kërkon jo vetëm administrimin formal të informacionit, por një akses real dhe të mjaftueshëm në materialet e përcjella nga organet kompetente. Ky standard është i domosdoshëm për të krijuar bindjen e brendshme mbi besueshmërinë dhe bazueshmërinë e të dhënave, veçanërisht në rastet që lidhen me sigurinë kombëtare.
119. Në jurisprudencën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (*shih çështjet Lupşa k. Rumanisë, Nr. 10337/04, datë 08.06.2006. C.G. dhe të tjerë k. Bullgarisë Nr. 1365/07, datë 13.03.2007, Regner k. Republikës Çeke, Nr. 35289/11, datë 19.09.2017, Muhammad dhe Muhammad k. Rumanisë, Vendim i Dhomës së Madhe Nr. 80982/12, datë 15/10/2020, Corneschi k. Rumanisë, Nr. 21609/16, datë 11.01.2022*), por edhe në praktikën e Kolegjit

Administrativ të Gjykatës së Lartë (*Hanem Mohamed & Abdelaziz Ibrahim kundër Ministrisë së Brendshme, vendimi nr. 00-2021-142*), në vijimësi është theksuar se barrën e provës dhe detyrimin për të ofruar informacion të plotë e mban organi publik që administron të dhënat e klasifikuara. Ky organ duhet të sigurojë që materiali i përcjellë të jetë i mjaftueshëm, i arsyetuar dhe i kontrollueshëm, në mënyrë që organi vendimmarrës të ketë mundësinë të formojë një bindje të bazuar. Nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut rezulton se, në rastet kur provat i janë mbajtur të fshehta mbrojtjes për arsye të interesit publik, nuk është detyrë e Gjykatës të vendosë nëse një mos-zbulim i tillë ka qenë apo jo rreptësisht i nevojshëm, pasi, si rregull i përgjithshëm, u takon gjykatave kombëtare të vlerësojnë provat që paraqiten përpara tyre. Në këtë mënyrë, për të siguruar që palët të përfitojnë nga një gjykim i drejtë në përputhje me parashikimet e Nenit 6 të Konventës (KEDNJ), çdo kufizim i të drejtave të saj duhet të balancohet në mënyrë të mjaftueshme nga procedurat e ndjekura nga autoritetet gjyqësore, apo në këtë rast nga autoriteti që i dërgohet për vlerësim ky informacion.

120. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi thekson se nuk mund të marrë një vendim mbi ndalimin për kandidim lidhur me integritetin e një kandidati nëse informacioni i ofruar është i fragmentuar ose i paplotë, pasi një vendimmarrje e tillë do të binte ndesh me parimin e sigurisë juridike, me prezumimin e pafajësisë dhe me standardin e një procesi të rregullt ligjor. Në këtë kuptim, nuk bëhet fjalë për mungesë kapaciteti nga ana e Këshillit, por për mospërmbushje të detyrimit nga organi që prodhon dhe administron informacionin për ta ofruar në atë mënyrë të qartë dhe të verifikueshme.

Duhet pasur parasysh se KED, ndonëse nuk është gjykatë në kuptimin e ngushtë, është një institucion kushtetues me rol *quasigjyqësor*, ndaj vendimmarrja e tij duhet të jetë e drejtë në përmbajtje, e arsyeshme në argumentim dhe e besueshme në perceptimin publik. Për këtë arsye, është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e organeve publike që ofrojnë informacion të klasifikuar që të garantojnë një material të qartë dhe të mjaftueshëm, në mënyrë që Këshilli të ushtrojë funksionin e tij në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare. Në këtë këndvështrim, Këshilli ka detyrimin kushtetues dhe ligjor që brenda veprimtarisë quasi gjyqësore dhe hetimore administrative, të balancojë vendimmarrjen me parimin *in dubio pro reo*, në ato raste kur verifikimi gjyqësor i informacionit bëhet i pamundur. Një qëndrim i ndryshëm do cenonte sundimin e ligjit, procesin e rregullt dhe drejtësinë e procedurës. Për rrjedhojë, mbi këtë informacion të siguruar nuk arrihet të vihet në dyshimi integriteti i kandidatës dhe as të cenohet besueshmëria e procesit të verifikimit.

121. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, mbështetur në konsideratat më lart dhe bazuar në njohjen dhe shqyrtimin e informacionit të klasifikuar të dërguar nga agjencitë ligjzbatuese, vjen në përfundimin se, edhe për këtë kriter, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kandidatja në rastin në shqyrtim nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.
122. Për sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset lejimi i kandidimit të kandidatës **Genta Tafa Bungo** në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Gjykata e Lartë në datën 11.12.2024.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të 7/ç të ligjit nr. 8577/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 229, 235, 236, 237 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si edhe pikave 17, 25, 26, 33, 57, 58, 79, 91 të vendimit të KED-së nr. 4, datë 11.03.2019, “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

VENDOSI:

1. Lejimin e kandidimit të znj. Genta Tafa në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Gjykata e Lartë e Shqipërisë në datën 11.12.2024;
2. Në zbatim të nenit 238 të Ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatës **Genta Tafa Bungo**.
3. Kandidatja kandidatës **Genta Tafa Bungo** ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, jo më vonë se 5 ditë nga dita e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

Datë 28.07.2025

ANËTAR

Zv/KRYETARE

KRYETAR

Ilir TOSKA

(Pjesërisht kundër)
Mariana SEMINI

Sokol SADUSHI

ANËTAR ZËVENDËSUES

ANËTARE ZËVENDËSUESE

ANËTARE

Thoma JANO

(kundër)
Elvana ÇIÇOLLI

Enkela VLORA

ANËTARE
(Pjesërisht kundër)

ANËTAR

ANËTARE
(Pjesërisht kundër)

Irma BALLI

Etien KAPO

Nafije HASKO

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi 2025

Adresa Postare : GJYKATA E LARTË, Rruga Ibrahim Rugova, Ndërtesa nr. 20, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri.

Adresa Elektronike : info@ked.gov.al; Numra telefonikë : +355 4 2257302